



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2024 – Numri: 1

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 3 janar 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 100/2023, datë 14.12.2023	Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike..... 3
Dekret i Presidentit nr. 398, datë 28.12.2023	Për shpallje ligji..... 10
Ligj nr. 101/2023, datë 14.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”..... 10
Dekret i Presidentit nr. 399, datë 28.12.2023	Për shpallje ligji..... 12
Dekret i Presidentit nr. 391, datë 26.12.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 12
Dekret i Presidentit nr. 395, datë 27.12.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 12
Dekret i Presidentit nr. 396, datë 27.12.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 13
Dekret i Presidentit nr. 397, datë 27.12.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 13
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Eva Mustafa Alikaj..... 13
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 773, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Muharrem Irfan Hoxha..... 14
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 774, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Roland Dhiogjen Xhoxhi..... 14

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Leonard Sotiraq Tase.....	14
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Suzana Vero Frashëri.....	14
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Aurel Anastas Plasari.....	15
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 778, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Mimoza Fuat Ibrahim.....	15
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 779, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Nazmi Qamil Hoxha.....	15
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Zhuljana Gaço Jorganxhi.....	16
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Xhelal Shefik Kalaja.....	16
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Pavllo Kozma Mihali.....	16
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 783, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Diana Ali Mata.....	16
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Federik Kolë Ndoci.....	17
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 785, datë 28.12.2023	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Ardian Qazim Cerga.....	17
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 28.12.2023	Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror znj. Lulëzime Ali Duka....	17
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 28.12.2023	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024.....	18
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 795, datë 28.12.2023	Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të <i>Acquis (Screening)</i> , në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian.....	96
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 797, datë 28.12.2023	Për përcaktimin e rasteve dhe të rregullave për shpërblimin në natyrë të shpronësimeve për interes publik.....	97

**LIGJ**
Nr. 100/2023**PËR LLOGARINË E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE**¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe kushteve për hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesave me shërbime bazike për konsumatorët dhe rezidentët në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit, historikut të aftësisë paguese brenda Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës për aksesin në një llogari pagese me shërbime bazike për konsumatorët, si një mjet i domosdoshëm për të mundësuar pjesëmarrjen e konsumatorëve në tregun financiar, bazuar në interesin e tyre të vërtetë për të pasur një llogari të tillë, e cila do t'i lejojë ata të marrin përfitimet që sjell tregu financiar.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Subjekte të këtij ligji janë bankat dhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me direktivën 2014/92/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 korrik 2014, “Mbi krabasueshmërinë e tarifave në lidhje me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave

Neni 4**Përfashtimi nga fusha e zbatimit**

Ky ligj nuk zbatohet për llogaritë e pagesave për personat juridikë, mikrondërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla e personat fizikë tregtarë.

Neni 5
Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas nenit 5 të ligjit nr. 55/2020, “Për shërbimet e pagesave”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Konsumator” ka të njëjtin kuptim si në pikën 6 të nenit 3 të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

b) “Llogari pagesash me shërbime bazike” është një llogari pagesash, e cila ka karakteristikat e parashikuara në nenin 7 të këtij ligji;

c) “Rezident” është personi, shtetas shqiptar apo i huaj, me ose pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe refugjatët apo refugjatët dhe personat në mbrojtje plotësuese, që kanë fituar të drejtën për azil në Republikën e Shqipërisë;

ç) Termat “konsumator” dhe “rezident” do të referohen kudo si “konsumator”.

KREU II
LLOGARIA E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE**Neni 6**
Procedura për hapjen e llogarive të pagesave me shërbime bazike

1. Llogaria e pagesave me shërbime bazike iu ofrohet konsumatorëve në Republikën e Shqipërisë nga të gjitha bankat që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit, historikut të aftësisë

me shërbime bazike”, numri CELEX 32014L0092, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 257, datë 28.8.2014, faqe 214–246.



paguese të konsumatorëve brenda Republikës së Shqipërisë.

2. Bankat kryejnë hapjen e llogarisë së pagesave me shërbime bazike ose refuzojnë aplikimin e një konsumatori për hapjen e një llogarie të tillë në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pune pas marrjes së aplikimit të plotë.

3. Bankat nuk hapin një llogari pagesash me shërbime bazike në rastet kur hapja e një llogarie të tillë rezulton në shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Në këto raste bankat njoftojnë autoritetin përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe zbatojnë kërkesat e legjislacionit dhe akteve nënligjore të sipërpërmendura.

4. Bankat nuk hapin një llogari pagesash me shërbime bazike në rastet kur konsumatori mban një llogari pagese ekzistuese në një bankë tjetër në Shqipëri, e cila e lejon atë të përdorë shërbimet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji, përveç rasteve kur konsumatori deklaron se është njoftuar për mbylljen e llogarisë së pagesave në bankën tjetër.

5. Konsumatori me paraqitjen e kërkesës për hapjen e llogarisë së pagesave me shërbime bazike deklaron se nuk disponon llogari pagesash në një bankë tjetër dhe jep pëlqimin për verifikimin e kësaj deklarate nga banka.

6. Banka para hapjes së llogarisë së pagesave me shërbime bazike ka të drejtë të verifikojë nëse konsumatori mban ose jo një llogari pagesash në një bankë tjetër.

7. Në rast se banka vërteton se konsumatori ka një llogari pagesash në një bankë tjetër dhe rrjedhimisht ka dhënë deklaratë të pavërtetë për hapjen e llogarisë së pagesave me shërbime bazike, banka nuk i ofron këtij konsumatori të drejtën e hapjes së një llogarie pagesash me shërbime bazike për një periudhë kohore prej 24 muajsh. Kjo klauzolë duhet të parashikohet edhe në kontratën e bankës me klientin në rastin e hapjes së llogarisë së pagesave me shërbime bazike.

8. Në rastet e përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 7 të këtij neni, banka pas marrjes së vendimit informon menjëherë konsumatorin për refuzimin e kërkesës për hapjen ose për mbylljen e llogarisë, si dhe arsyen për marrjen e këtij vendimi, me shkrim, në letër ose nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit dhe pa pagesë, përveç rasteve kur dhënia e një informacioni të tillë është në kundërshtim me

objektivat e sigurisë kombëtare ose kuadrin ligjor dhe rregullativ të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në rast refuzimi të kërkesës për hapjen e një llogarie pagesash me shërbime bazike ose të mbylljes së llogarisë, banka e këshillon konsumatorin për procedurën e paraqitjes së ankesës kundër refuzimit dhe për të drejtën e tij për ankimim pranë Bankës së Shqipërisë brenda 30 ditëve nga data e refuzimit për hapjen e llogarisë.

9. Hapja dhe përdorimi i një llogarie pagesash me shërbime bazike nuk kushtëzohet me blerjen e produkteve/shërbimeve shtesë të ofruara nga banka.

Neni 7

Karakteristikat e llogarisë së pagesave me shërbime bazike

1. Llogaria e pagesave me shërbime bazike përfshin shërbimet e mëposhtme:

a) shërbime që mundësojnë të gjitha operacionet e kërkuara për hapjen, funksionimin dhe mbylljen e një llogarie pagesash;

b) shërbime që mundësojnë depozitimin e fondeve në një llogari pagesash;

c) shërbime që mundësojnë tërheqjen e fondeve nga një llogari pagesash brenda Shqipërisë në sportele ose në ATM (*automated teller machines*) gjatë ose jashtë orarit zyrtar të punës së bankave;

ç) ekzekutimin e transaksioneve të mëposhtme të pagesave brenda territorit të Republikës së Shqipërisë:

i. debitimet direkte;

ii. transaksionet e pagesave përmes një karte (përjashtuar transaksionet e pagesave me karta krediti), përfshirë pagesat *online*;

iii. transfertat e kreditit, përfshirë pagesat periodike, aty ku është e zbatueshme, në terminale dhe në sportelet e bankës dhe nëpërmjet platformave *online*.

2. Banka ofron shërbimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni për konsumatorët për llogarinë e pagesave me shërbime bazike në të njëjtën mënyrë si ofrohen për klientët llogaritë e tjera të pagesave, përveç kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

3. Bankat ofrojnë llogaritë e pagesave me shërbime bazike vetëm në monedhën vendase (lekë).

4. Konsumatorët kryejnë një numër të pakufizuar transaksionesh të pagesave në lidhje me shërbimet e



përcaktuara në pikën 1 të këtij neni nëpërmjet llogarive të pagesave me shërbime bazike.

5. Bankat u mundësojnë konsumatorëve administrimin dhe kryerjen e transaksioneve të pagesave nga llogaria e pagesave me shërbime bazike në degët e bankës dhe nëpërmjet platformave *online*, kur është e aplikueshme.

6. Llogaria e pagesës me shërbime bazike nuk ka në asnjë moment një tepriçë negative. Bankat nuk lejohen të ofrojnë kredi të lidhura me llogarinë e pagesave me shërbime bazike, si dhe nuk lejohen në asnjë rast të tejkalojnë tepriçën kreditore të llogarisë.

7. Bankat nuk lejojnë ekzekutimin e transaksioneve të pagesave nëse në llogarinë e pagesës me shërbime bazike nuk ka tepriçë kreditore të mjaftueshme për të ekzekutuar një transaksion page dhe/ose aplikim tarife.

Neni 8

Tarifat e llogarisë së pagesës me shërbime bazike

1. Bankat ofrojnë shërbimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji pa aplikuar tarifa ose kundrejt një tarife të arsyeshme.

2. Transaksionet e pagesave përmes një karte debiti, të parashikuara në nënndarjen “ii” të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 7 të këtij ligji, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë kryhen pa pagesë ose kundrejt një tarife të arsyeshme, siç parashikohet në këtë nen. Për transaksionet e pagesave përmes një karte, të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bankat aplikojnë tarifa, të cilat nuk janë më të larta se ato që banka aplikon sipas politikës së brendshme për përcaktimin e tarifave.

3. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, metodologjia e përllogaritjes së tarifës së arsyeshme nga bankat përcaktohet me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, duke konsideruar të paktën nivelin e të ardhurave kombëtare dhe tarifatat mesatare të aplikuara nga bankat për shërbimet e pagesave të ofruara në llogaritë e pagesave.

4. Tarifatat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni zbatohen për të gjitha shërbimet e llogarisë së pagesave me shërbime bazike të parashikuara në nenin 7, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nënndarja “ii”, të këtij ligji, pavarësisht nga numri i veprimeve të kryera në llogarinë e pagesave me shërbime bazike.

5. Përveç sa parashikohet në pikën 4 të këtij neni, tarifatat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, zbatohen edhe për shërbimet e përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “iii” të shkronjës “ç” të nenit 7 të këtij ligji për një numër total maksimal prej 5 transaksione pagesash në muaj për shërbimet e përcaktuara në këtë pikë. Tarifatat për çdo transaksion pagesash mbi numrin prej 5 transaksione pagesash në muaj për shërbimet e përcaktuara në këtë pikë nuk janë më të larta se ato që banka aplikon sipas politikës së brendshme për përcaktimin e tarifave.

6. Për depozitimet e fondeve, tërheqjet e fondeve dhe ekzekutimin e transaksioneve të pagesave që nuk kryhen në ATM-në e vetë bankës ose përmes kanaleve *online* të saj aplikohen tarifatat që normalisht aplikohen edhe për klientët e tjerë.

7. Bankat ofrojnë të gjitha shërbimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji me tarifë zero, pavarësisht nga numri i veprimeve të kryera në llogarinë e pagesave me shërbime bazike, për kategoritë e konsumatorëve që i përkasin grupit të konsumatorëve, të cilët përfitojnë nga programet dhe politikat për skemat e ndihmës ekonomike dhe sociale sipas legjislacionit përkatës në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

a) përfituesit e pagesës së papunësisë sipas ligjit që rregullon nxitjen e punësimit në Republikën e Shqipërisë;

b) familjet dhe individët, të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike sipas ligjit që rregullon asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë;

c) përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar dhe ndihmësit personalë të tyre sipas ligjit që rregullon asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë;

ç) individët përfitues të statusit të invalidit dhe ndihmësit personal të tyre sipas ligjit që rregullon statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik në Republikën e Shqipërisë;

d) individët përfitues të statusit të të verbrit dhe ndihmësit personal të tyre sipas ligjit që rregullon statusin e të verbrit në Republikën e Shqipërisë;

dh) invalidët e punës sipas ligjit që rregullon statusin e invalidëve të punës në Republikën e Shqipërisë, për pagesën shtesë mbi pensionin e invaliditetit;

e) jetimët që kanë përfituar statusin sipas ligjit që rregullon statusin e jetimit në Republikën e Shqipërisë;

ë) përfituesit e masës së financimit për fëmijën e vendosur në familje kujdestare me vendim gjykatë;



f) përfituesit e pensionit social bazuar në ligjin që rregullon sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të cilët nuk plotësojnë kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk kanë të ardhura ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social;

g) përfituesit e pensionit të pleqërisë sipas përcaktimeve në ligjin që rregullon sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

gj) përfituesit e invaliditetit, si dhe përfituesit e pensionit të invaliditetit të përhershëm për shkak të aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale, sipas përcaktimeve në ligjin që rregullon sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

h) përfituesit e pensionit familjar sipas përcaktimit në ligjin që rregullon sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

i) përfituesit e ndihmës ekonomike për arsimin e lartë bazuar në listën e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 9

Kontrata për hapjen e llogarisë së pagesave me shërbime bazike

Llogaria e pagesave me shërbime bazike rregullohet nga kontrata tip, e cila është subjekt i kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 55/2020, “Për shërbimet e pagesave”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në pikat 1 dhe 2 të nenit 10 të këtij ligji.

Neni 10

Zgjidhja e kontratës

1. Banka zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën e llogarisë së pagesave me shërbime bazike vetëm nëse plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) konsumatori ka përdorur llogarinë e pagesave për qëllime të paligjshme;

b) nuk ka pasur asnjë transaksion në llogarinë e pagesave për më shumë se 24 muaj rresht;

c) konsumatori ka paraqitur informacion të pasaktë për të hapur llogarinë e pagesave me shërbime bazike në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji;

ç) konsumatori nuk gëzon më cilësinë e rezidentit në Republikën e Shqipërisë sipas përkufizimit të rezidentit në këtë ligj;

d) konsumatori ka hapur më pas një llogari të dytë pagesash në Republikën e Shqipërisë, e cila i lejon atij të përdorë shërbimet e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.

2. Në rastet kur banka zgjidh kontratën për një llogari pagesash me shërbime bazike për një ose më shumë prej arsyeve të parashikuara në shkronjat “b”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni, ajo informon konsumatorin për arsyet e zgjidhjes së saj, në formën e rënë dakord në kontratë dhe pa pagesë, të paktën dy muaj para se zgjidhja e kontratës të hyjë në fuqi, me përjashtim të rasteve kur bëra publike e këtij informacioni është në kundërshtim me objektivat e sigurisë kombëtare ose interesit publik.

3. Kur banka zgjidh kontratën në rastet e parashikuara në shkronjat “a” ose “c” të pikës 1 të këtij neni, zgjidhja e kontratës hyn në fuqi menjëherë.

4. Banka e këshillon konsumatorin nëpërmjet njoftimit për zgjidhjen e kontratës për procedurën e paraqitjes së ankesës për zgjidhjen e kontratës, nëse ka, dhe për të drejtën e konsumatorit për ankimim në Bankën e Shqipërisë, si dhe i siguron edhe detajet përkatëse të kontaktit.

Neni 11

Detyrimi për informim të konsumatorëve në lidhje me ofrimin e llogarisë së pagesës me shërbime bazike

1. Bankat vendosin në dispozicion të konsumatorëve, pa pagesë, informacionin e qartë dhe të kuptueshëm për të drejtën për të hapur dhe për të përdorur një llogari pagesash me shërbime bazike.

2. Bankat vendosin në dispozicion të konsumatorëve, pa pagesë, informacionin në lidhje me tiparet specifike të llogarisë së pagesave me shërbime bazike dhe kushtet e përdorimit, si dhe hapat që konsumatorët duhet të ndërmarrin për të ushtruar të drejtën e tyre për të hapur një llogari pagesash me shërbime bazike.

3. Informacioni duhet të bëjë të qartë se përfitimi i shërbimeve shtesë nuk është i detyrueshëm për të hapur një llogari pagesash me shërbime bazike.

4. Informacionin e parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni banka e publikon në hapësira të



dukshme dhe lehtësisht të aksesueshme nga konsumatorët nëpërmjet broshurave në degët e bankës, si dhe në faqen zyrtare të internetit të bankës.

Neni 12
Ankesat e konsumatorëve

1. Kur banka refuzon hapjen e llogarisë së pagesave me shërbime bazike ose konsumatori vlerëson se bankat kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, konsumatori ka të drejtën e ankimit në Bankën e Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë shqyrton ankesën sipas pikës 1 të këtij neni brenda 15 ditëve pune nga paraqitja e saj.

3. Banka e Shqipërisë, në rast se pas shqyrtimit të ankesës së konsumatorit konstaton se nuk ekzistojnë shkaqet e përcaktuara në këtë ligj për refuzimin e hapjes së llogarisë së pagesave me shërbime bazike, kërkon nga banka hapjen e kësaj llogarie brenda 15 ditëve pune nga njoftimi i vendimit të Bankës së Shqipërisë.

Neni 13
**Konvertimi i llogarisë aktuale në llogari
pagese me shërbime bazike**

Konsumatorëve, të cilët posedojnë llogari të tjera përveç llogarisë së pagesave me shërbime bazike, u lind e drejta, me kërkesë të tyre, të pajisen me një llogari pagese me shërbime bazike. Kjo realizohet duke konvertuar një llogari ekzistuese në një llogari pagesash me shërbime bazike ose duke hapur një llogari të re e duke mbyllur atë ekzistuese nëse plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 14
**Krahasueshmëria dhe transparenca e
tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe
transferimi i llogarive të pagesave**

Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor kërkesat për krahasueshmërinë dhe transparencën për tarifave të lidhura me llogarinë e pagesave me shërbime bazike, si dhe për shërbimin e transferimit të llogarisë së pagesave me shërbime bazike.

KREU III
**AUTORITETET PËRGJEGJËSE,
BASHKËPUNIMI DHE SEKRETI
PROFESIONAL**

Neni 15
Autoritetet përgjegjëse dhe bashkëpunimi

1. Banka e Shqipërisë ushtron funksionin mbikëqyrës për bankat në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritete të tjera vendase ose të huaja për zbatueshmërinë e kërkesave të këtij ligji.

Neni 16
Sekreti profesional

1. Administratorët, të punësuarit dhe agjentët aktualë e të mëparshëm të bankës ose degës së bankës së huaj, autoritetet gjyqësore, si dhe inspektorët apo nëpunësit e tjerë të Bankës së Shqipërisë ose të autoriteteve përkatëse të huaja të mbikëqyrjes bankare kanë detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional për informacionet e marra gjatë ushtrimit të detyrës në përputhje me nenin 91 të ligjit nr. 9662 datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Në rast të bashkëpunimit ndërinstitucional, në shkëmbimin e informacionit, është e detyrueshme ruajtja e sekretit profesional për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe tregtare.

3. Banka e Shqipërisë shkëmben informacion me autoritetet mbikëqyrëse të huaja dhe bankat qendrore të huaja duke respektuar parimin e reciprocitetit, të miratimit paraprak, mjaftueshmërisë së të dhënave, integritetit dhe konfidencialitetit, me kusht që të garantohet niveli i mbrojtjes së të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17
**Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave
personale**

Përpunimi i të dhënave personale, për qëllime të këtij ligji, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Subjektet, sipas fushës së zbatimit të këtij ligji, aksesojnë,



përpunojnë dhe mbajnë të dhëna personale të nevojshme për hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesave me shërbime bazike, me pëlqimin e shprehur qartazi të subjektit të të dhënave.

KREU IV
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE,
SANKSIONET DHE ANKIMET

Neni 18

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji konsiderohen si kundërvajtje administrative.

2. Banka e Shqipërisë vendos gjobë nga 50 000 lekë deri në 250 000 lekë për bankat kur pas ankesës së konsumatorëve ose kryesisht konstatohen shkeljet e mëposhtme:

a) banka nuk kryen hapjen e llogarisë së pagesave me shërbime bazike ose refuzon aplikimin për hapjen e saj brenda afatit kohor të parashikuar në pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji;

b) banka vepron në kundërshtim me kërkesat e pikës 8 të nenit 6 të këtij ligji lidhur me njoftimin e konsumatorëve për refuzimin e aplikimit për hapjen e llogarisë së pagesave me shërbime bazike;

c) banka në njoftimin e konsumatorit për refuzimin e hapjes së llogarisë së pagesës me shërbime bazike nuk e këshillon konsumatorin për të drejtën për ankim, sipas parashikimeve në pikën 8 të nenit 6 të këtij ligji;

ç) banka e kushtëzon konsumatorin për hapjen e llogarisë së pagesave me shërbime bazike për blerjen e shërbimeve shtesë të ofruara nga banka në kundërshtim me parashikimet e pikës 9 të nenit 6 të këtij ligji;

d) ofrimi i shërbimeve në një llogari pagesash me shërbime bazike nuk kryhet në të njëjtën mënyrë siç ofrohet për konsumatorët që mbajnë llogari pagesash sipas parashikimeve në pikën 2 të nenit 7 të këtij ligji;

dh) banka ofron llogari pagesash me shërbime bazike në një monedhë të ndryshme nga monedha lekë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të nenit 7 të këtij ligji;

e) banka nuk i lejon konsumatorët të ekzekutojnë një numër të pakufizuar transaksionesh në lidhje me shërbimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji, në kundërshtim me kërkesat e pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji;

ë) banka nuk i mundëson konsumatorit administrimin dhe kryerjen e transaksioneve të pagesave nga llogaria e pagesave me shërbime bazike sipas parashikimeve në pikën 5 të nenit 7 të këtij ligji;

f) banka ofron kredi lidhur me llogarinë e pagesave me shërbime bazike në kundërshtim me kërkesat e pikës 6 të nenit 7 të këtij ligji;

g) banka në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji zbaton tarifa ndaj konsumatorit, të cilat nuk janë të parashikuara në politikën e brendshme për përcaktimin e tarifave;

gj) banka vendos ndaj konsumatorit, që mban një llogari pagesash me shërbime bazike, një tarifë që tejkalon nivelin e tarifës së arsyeshme të llogarit, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 8 të këtij ligji;

h) banka vendos ndaj konsumatorit, që mban një llogari pagese me shërbime bazike, tarifa më të larta se ato që banka aplikon sipas politikës së brendshme për përcaktimin e tarifave për çdo transaksion pagesash mbi numrin prej 5 transaksione pagesash në muaj, të përcaktuar në pikën 5 të nenit 8 të këtij ligji;

i) banka aplikon tarifë ndaj grupit të konsumatorëve në kundërshtim me parashikimet e pikës 7 të nenit 8 të këtij ligji;

j) banka zgjidh në mënyrë të njëanshme një kontratë tip të llogarisë së pagesave me shërbime bazike në kundërshtim me kushtet e parashikuara në pikën 1 të nenit 10 të këtij ligji dhe me kushtet e tjera të kontratës së lidhur midis palëve, të cilat janë të bazuara në legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë;

k) banka nuk e informon konsumatorin për përfundimin e kontratës së llogarisë së pagesës me shërbime bazike sipas mënyrës së parashikuar në pikën 2 të nenit 10 të këtij ligji;

l) banka në njoftimin ndaj konsumatorit, sipas kërkesave të pikave 2 dhe 3 të nenit 10 të këtij ligji, nuk e këshillon konsumatorin për të drejtën për ankim sipas parashikimeve në pikën 4 të nenit 10 të këtij ligji;

ll) banka nuk e informon konsumatorin në lidhje me ofrimin e llogarisë së pagesave me shërbime bazike sipas parashikimeve në nenin 11 të këtij ligji.

3. Në përcaktimin e masës së gjobës, sipas pikës 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë mban në konsideratë:

a) rrethanat në të cilat është kryer shkelja;

b) pasojat e shkeljes;



c) përsëritjen e shkeljes;

ç) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes.

4. E drejta për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative të parashikuara në këtë nen nuk ushtrohet kur kanë kaluar 6 muaj nga çasti i kryerjes së kundërvajtjes administrative.

5. Gjobat e vendosura sipas këtij neni janë tituj ekzekutivë dhe arkëtohen për llogari të Bankës së Shqipërisë.

6. Banka e Shqipërisë përcakton nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës autoritetin përkatës që do të nxjerrë aktet administrative në lidhje me masat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 19

Publikimi i sanksioneve administrative

1. Banka e Shqipërisë publikon në faqen zyrtare të internetit sanksionet administrative të vendosura për shkelje të dispozitave të këtij ligji. Publikimi bëhet menjëherë pasi banka është informuar për atë sanksion administrativ, duke përfshirë informacione për llojin e natyrën e shkeljes.

2. Në rastin e publikimit të sanksioneve administrative, kundër të cilave është bërë ankesë, Banka e Shqipërisë publikon informacionin për statusin e ankesës dhe rezultatin e saj.

3. Publikimi në përputhje me këtë nen qëndron në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë maksimumi një vit.

4. Banka e Shqipërisë nuk publikon sanksionet administrative vetëm në rast se në gjykimin e saj publikimi rrezikon seriozisht stabilitetin e tregjeve financiare ose u shkakton dëm joproportional palëve të përfshira.

Neni 20

Ankimi administrativ

1. Çdo bankë, e cila pretendon se të drejtat dhe interesat e ligjshme të saj janë cenuar nga akte administrative të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, bazuar në dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë të kryejë ankim administrativ te Guvernatori i Bankës së Shqipërisë brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e aktit.

2. Realizimi i ankimit administrativ sipas këtij neni është kusht paraprak për kundërshtimin e aktit në gjykatë.

3. Ankimi administrativ paraqitet dhe shqyrtohet sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

4. Guvernatori në përfundim të shqyrtimit të ankimit administrativ, sipas këtij neni, vendos:

a) lënien në fuqi të aktit administrativ dhe rrezimin e ankimit;

b) shfuqizimin e aktit administrativ dhe pranimin e ankimit;

c) ndryshimin e aktit administrativ, duke pranuar pjesërisht ankimin.

Neni 21

Ankimi gjyqësor

Çdo bankë ka të drejtë të paraqesë ankim gjyqësor kundër vendimit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nxjerrë sipas nenit 20 të këtij ligji, bazuar në legjislacionin që rregullon gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Aktet nënligjore

Ngarkohet Banka e Shqipërisë për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 3, dhe 14 të këtij ligji brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.12.2023.

Shpallur me dekretin nr. 398, datë 28.12.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.



DEKRET
Nr. 398, datë 28.12.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 100/2023, “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 101/2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 72/2019, “PËR MASAT
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) në fjalinë hyrëse hiqet togfjalëshi “organizatave ndërkombëtare”.

b) shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) të kontrolluara apo të zotëruara tërësisht, pjesërisht apo bashkërisht, direkt apo indirekt, nga entitetet e lartpërmendura;”.

2. Fjalja hyrëse e pikës 6 ndryshohet si më poshtë:

“Masat shtrënguese financiare” janë masa që ndalojnë përfitimin ose vënien e të gjitha fondeve dhe asetëve, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në dispozicion të personave apo entiteteve të shpallura dhe bllokojnë përdorimin e të gjitha fondeve dhe asetëve:”.

3. Pas pikës 17 shtohet pika 18 me këtë përmbajtje:

“18. “Subjekte të tjera zbatuese” është çdo person juridik publik ose privat, çdo tregtar ose person tjetër fizik, sipas përcaktimeve të legjislacionit civil e tregtar në Republikën e Shqipërisë, të cilat ngarkohen me zbatimin e këtij ligji.”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2 fjalët “Këshilli i Ministrave miraton” zëvendësohen me fjalët “Këshilli i Ministrave merr vendim për”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme, më poshtë referuar si “ministra”, njofton menjëherë organet përgjegjëse për masat shtrënguese ndërkombëtare, të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 3 të këtij ligji.”.

3. Në pikën 4 fjalët “deri në miratimin e vendimit” zëvendësohen me fjalët “deri në marrjen e vendimit”.

4. Në pikën 6 fjalët “Këshilli i Ministrave miraton” zëvendësohen me fjalët “Këshilli i Ministrave merr vendim për”.

5. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Kur pas vendosjes, ndryshimit ose shfuqizimit të masave shtrënguese ndërkombëtare është e nevojshme ndërmarrja e masave ose veprimeve të tjera për zbatimin e vendimit, sipas masave ose veprimeve të ndërmarra nga organizata ndërkombëtare përkatëse, masat ose veprimet e tjera merren me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në propozimet e organeve përgjegjëse sipas nenit 11.”.

Neni 3

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “Organet përgjegjëse, organet publike, si dhe çdo person fizik ose juridik



në Republikën e Shqipërisë” zëvendësohen me fjalët “Organet përgjegjëse dhe subjektet e tjera zbatuese në Republikën e Shqipërisë”.

2. Pikat 4, 5 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:

“4. Të dhënat e plota për rastet e bllokuara, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshirë transaksionet e mbetura në tentativë, i njoftohen menjëherë organit përgjegjës në përputhje me fushën e tij të përgjegjësive, duke kërkuar udhëzime nëse duhet të kryhen apo jo transaksione apo të kryhen veprime të mëtejshme. Organi përgjegjës kryen verifikimet përkatëse dhe u kthen përgjigje subjekteve të pikës 1 të këtij neni brenda 48 orëve.

5. Vendimet e organeve përgjegjëse dhe subjekteve të tjera zbatuese në Republikën e Shqipërisë kanë fuqi të drejtpërdrejtë, të menjëhershme dhe kanë vlefshmëri për një periudhë jo më shumë se 30 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas marrjes së udhëzimeve sipas pikës 4 të këtij neni.

7. Vendimet e marra sipas pikës 5 të këtij neni vihen në dispozicion nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të organeve përgjegjëse.”.

Neni 4

Në nenin 10 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Komiteti përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë drejtues të organeve përgjegjëse, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 11, si dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, Shërbimit Informativ të Shtetit, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoritetit Kombëtar të Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.

Përfaqësuesit e emëruar, që marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit, përfitojnë një pagesë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në çdo mbledhje të Komitetit, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Në pikën 5 pas fjalës “ përfaqësues” shtohen fjalët “dhe sipas rastit, ekspertë të jashtëm”.

Neni 5

Në nenin 11 bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “d” të pikës 1 shtohen shkronjat “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“dh) Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe strukturat në varësi të saj, për masat shtrënguese mbi pasuritë e paluajtshme;

e) ministritë apo autoritetet përkatëse, për institucionet në varësi dhe për subjektet që licencojnë apo mbikëqyrin, që mbajnë ose administrojnë regjistra të fondeve dhe pasurive të tjera, për masat shtrënguese që lidhen me to.”.

2. Pas shkronjës “e” të pikës 2 shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) njoftojnë menjëherë subjektet ndaj të cilave vendosen, ndryshojnë apo shfuqizohen masat shtrënguese ndërkombëtare.”.

Neni 6

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalët “Organi përgjegjës ka detyrimin të bllokojë” zëvendësohen me fjalët “Organi përgjegjës dhe subjektet e tjera zbatuese në Republikën e Shqipërisë kanë detyrimin të bllokojnë”.

2. Në shkronjën “b” të pikës 4 fjalët “nga kontrata të lidhura përpara listimit” zëvendësohen me fjalët “nga kontrata të hyra në fuqi përpara listimit”.

3. Në pikën 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në fjalinë e parë fjalët “të gjithë personat fizikë, juridikë dhe entet” zëvendësohen me fjalët “të gjitha organet përgjegjëse dhe subjektet e tjera zbatuese”.

b) fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Institucionet financiare dhe jofinanciare informojnë menjëherë organin kompetent, në përputhje me fushën e tij të përgjegjësive, për çdo aset të bllokuar, veprim të kryer apo transaksion të mbetur në tentativë.”.

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Administrimi i aseteve dhe fondeve të bllokuara sipas neneve 8 dhe 12 të këtij ligji bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi, që rregullojnë administrimin e të gjitha fondeve dhe aseteve të tjera financiare të bllokuara.”.

Neni 7

Pas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 13 shtohen shkronjat “ç” dhe “d” me këtë përmbajtje:

“ç) pagesat e tarifave të arsyeshme profesionale dhe pagesat e shpenzimeve të bëra që lidhen me



ofrimin e shërbimeve ligjore apo tarifave të shërbimit, në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar;

d) pagesat për titujt ekzekutivë apo proceset administrative, gjyqësore apo të arbitrazhit, nëse procesi ka filluar në një datë të mëparshme nga data e vendosjes së masës shtrënguese ndërkombëtare, me kusht që pagesat të mos jenë për llogari të personit të shpallur.”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.12.2023.

Shpallur me dekretin nr. 399, datë 28.12.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

**DEKRET
Nr. 399, datë 28.12.2023**

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 101/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 72/2019, ‘Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET
Nr. 391, datë 26.12.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës, neneve 8 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

- Robert Pashk Dedaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET
Nr. 395, datë 27.12.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ermal Gezim Tufi
2. Lejdjon Bukurosh Pisha
3. Elona Qemal Bala (Jahaj)
4. Oriola Stavri Popi
5. Leon Eraldo Fezga
6. Lea Eraldo Fezga
7. Xhina Petrit Sahiti (Hysenaj)
8. Leandro Ndriçim Bardho

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 396, datë 27.12.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Laureta Pëllumb Bardho (Xhalili)
2. Vanessa Ndriçim Bardho
3. Rezarta Skënder Demaj (Beci)
4. Fatma Betim Lushkja
5. Mariagreta Kristaq Mitro
6. Liana Petro Tasho (Halit)
7. Nerisa Nexhip Duraj (Beçoku)
8. Vivien Erion Duraj
9. Beatrix Erion Duraj
10. Xhesika Apostol Fezga

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË****Bajram Begaj****DEKRET****Nr. 397, datë 27.12.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Okan Ali Ezer
2. Asli Şuayip Kaya Bleta
3. Elisa Sante Favret

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj****VENDIM****Nr. 772, datë 28.12.2023****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
ZNJ. EVA MUSTAFA ALIKAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Eva Mustafa Alikaj, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 773, datë 28.12.2023****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. MUHARREM IRFAN HOXHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Muharrem Irfan Hoxha, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 774, datë 28.12.2023****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. ROLAND DHIQJEN XHOXHI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Roland Dhiqjen Xhoxhi, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta,

plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 775, datë 28.12.2023****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. LEONARD SOTIRAQ TASE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Leonard Sotiraq Tase, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 776, datë 28.12.2023****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z.NJ. SUZANA VERO FRASHËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Suzana Vero Frashëri, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 777, datë 28.12.2023

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. AUREL ANASTAS PLASARI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Aurel Anastas Plasari, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 778, datë 28.12.2023

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
ZNJ. MIMOZA FUAT IBRAHIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Mimoza Fuat Ibrahim, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 779, datë 28.12.2023

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. NAZMI QAMIL HOXHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Nazmi Qamil Hoxha, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta,



plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 780, datë 28.12.2023

**PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
ZNJ. ZHULJANA GAQO JORGANXHI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Zhuljana Gaqo Jorganxhi, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 781, datë 28.12.2023

**PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. XHELAL SHEFIK KALAJA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Xhelal Shefik Kalaja, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 782, datë 28.12.2023

**PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR
Z. PAVLLO KOZMA MIHALI**

							<p>makinerive te avancuara ne ndermarrjet/ industrine vendase</p> <p>Zhvillimi i zonave rurale/fshatrave per zhvillimin e turizmit/agriturizmit, bujtinave, fermave dhe ushqimit te shendetshem, per ruajtjen e tradites dhe kulinarise</p> <p>Rritja e te ardhurave te disponnueshme</p> <p>Mbeshtetjen siper marrjet e reja dhe investimi i diaspores me fokus ne zonat rurale permes mekanizmave nxites per brain circulation/brain gain dhe nxitjen e investimeve</p> <p>Nxitja e clusterave/shoqerive te bashkepunimit bujgesor</p> <p>Promovim i produkteve made in Albania</p> <p>Promovim i ndermarrjeve vendase per t'i kthyer ato qe jane pjese e prioriteteve te S£ ne lider rajonal</p> <p>Mbeshtetja per ta kthyer vendin ne destinacion turistik gjithëvjetor dhe te qendrueshem</p> <p>Kthimi i Shqiperise ne lider rajonal per energjine e rinovueshme dhe lendet e para, duke diversifikuar burimet per te plotesuar 100% nevojat e vendit dhe per ta kthyer ne eksportues neto te energjise se gjelber</p> <p>Permiresimi i sherbimeveper qytetaret, ne te gjithë vendin, permiresimi i transportit dhe sherbimeve shendetesorebdhe arsimore</p>	<p>kete nje impakt te rendesishem social me nje mundesi te shtuar zhvillimi te ekonomise ne zoonat rrale dhe ne gjithë Shqiperine.</p> <p>Inovacioni ne sektoret prioritare do te sjelle rritje te ekonomise, konkurrueshmeri te ndermarrjeve dhe promovimin e produkteve shqiptare ne bote.</p> <p>Mbeshtetja me teknologjite e reja dhe zgjidhjet smart per monitorimin e mjedisit, problemeve mjedisore dhe ndotjes, mundeson kontroll me te mire te territorit me nje impakt te konsiderueshem ne mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e ndotjes</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--



								<p>Nxijtjen e inovacionit dhe perdorimit te teknologjive te avancuara, ne shendetesi dhe permiresuar sherbimin shendetesor dhe social ne zonat rurale</p> <p>Ofrimi i programeve te edukimit ne vazhdim, per reskilling/upskilling per te pergatitur punonjes me njohuri te perditesuara ne sektoret prioritare per vendin, perfshire inovacionin, kerkim dhe zhvillim</p> <p>Investimi ne teknologji, inovacion dhe edukim per te kontribuar ne menaxhimin e integruar te mbetjeve permiresimi i sistemeve elektronike ne sektoret prioritare dhe horizontale mekanizma facilitues per mbeshtetjen e familjeve, famijeve dhe grave me fokus zonat rurale per te ndihmuar ne nje jete sociale me te mire, frenuar largimin e talenteve dhe krijuar mundesi pune dhe karriere ne keto zona si parakusht per zhvillimin inovativ te sektoreve prioritare te S3</p> <p>Mbeshtetja dhe incentivimi i programeve te perbashketa me universitete te BE krijimi i me shume mundesive duke zgjeruar rrjetin e qendrave dhe sherbimeve ne te gjitha vendin per femijet, talentet, angazhimin e grave</p> <p>Mbeshtetje e ndryshimeve te nevojshme per te mundesuar regjistrimin e</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--



								pronavebujqesore dhe hartat digjitale te pronave Forcimi i bashkepunimit rajonal me vendet firnje permes marreveshjeve bilaterale ose ne kuader te procesit te Berlinit per fushat me interes reciprok. Futja e metodologjive te avancuara smart ne ndihme te monitorimit te territorit per aktivitetet e ndermarrjeve, nderitime, etj		
40	Per percaktimin e llojeve te tarifave te sherbimeve te ofruara nga AKSHI dhe mases se tyre	Projektvendim	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (AKSHI)	Katërmujori III	Neni 36, pika 2 Ligj nr. 43/2023 "Për qeverisjen elektronike"	Tarifat e mbledhura nga ofrimi i shërbimeve të AKSHI-t në zbatim të këtij ligji, të shërbimeve të përcaktuara në ligjin për nënshkrimin elektronik dhe shërbimet e besuara derdhen në buxhetin e shtetit.	Jo	Fusha, Shoqëria Digjitale	Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022 – 2026, miratuar me VKM Nr. 370, datë 1.6.2022,	po
41	Për përcaktimin e autoritetit përgjegjës për mbledhjen e tarifave (open data), masa e këtyre tarifave dhe mënyra e pagesës	Projektvendim	Kryeministri-Zëvendëskryeministri (AKSHI)	Katërmujori III	Neni 43, pika2, Ligj nr. 43/2023 "Për qeverisjen elektronike"	Me qëllim krijimin e produkteve të reja të informacionit dhe shërbimeve, të cilat kanë si bazë informacionet dhe të dhënat që gjenden në portalin opendata.gov.al, si dhe për promovimin e zhvillimin e ekonomisë së të dhënave, autoritetet publike dhe AKSHI u ofrojnë personave fizikë dhe juridikë të drejtën e ripërdorimit të informacionit që prodhohet dhe mbahet nga autoritetet publike si pjesë e të dhënave të hapura.	JO	Fusha, Shoqëria Digjitale	Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022 – 2026, miratuar me VKM Nr. 370, datë 1.6.2022,	po
42	Për disa ndryshime në VKM nr. 268, datë 6.4.20216 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit", të ndryshuar	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmujori III	Ky projektvendim ka si qëllim miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren e Këshillit Kombëtar të Ujit, në vijim të miratimit të Projektvendimit ndryshues të VKM 550/2020	Ndryshimi i disa pikave të VKM-së aktuale 268/2016 në vijim të miratimit të Projektvendimit ndryshues të VKM 550/2020	Jo	Shoqëria digjitale, Nr. angazhimi 77	Jo	Jo
43	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.	Projektligj	Kryeministri - Zëvendëskryeministri (DAP)	Katërmujori III	Rregullimi i disa parashikimeve të ligjit, për shkak të	1. Rregullime në lidhje me kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbimin	Po PKIE 2024 - 2026	N/A	Strategjia Ndërsëktoriale e Reformës në	Po ndikime sociale



	152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar				<p>problematikave të vëna re gjatë zbatimit të tij, si dhe shtimi i disa parashikimeve të tjera të nevojshme në të, në funksion të qartësisë së institutëve të përcaktuara në ligj.</p>	<p>civil;</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Rregullime në lidhje me afatin e pezullimit të nëpunësve civilë që zgjidhen si anëtarë të këshillave bashkiakë; 3. Rregullime në lidhje me masën e demshpërblimit në rastin e lirimit të nëpunësit civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit; 4. Rregullime në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë; 5. Rregullime në lidhje me procesin e vlerësimit të punës së nëpunësve civilë; 6. Rregullime në lidhje me elementët e hapave të pagës; 7. Rregullime në lidhje me organizimin dhe funksionimin e ASPA-s. 		<p>Administratën Publike, 2023 - 2030, që pritet të miratoahet brenda vitit 2023</p>		
44	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"	Projektligj	Kryeministri - Zëvendëskryeministri (DAP)	Katërmujori III	<p>Rregullime për disa parashikime të ligjit, për shkak të problematikave të vëna re gjatë zbatimit të tij, të evidentuara edhe në nga raportet e progresit të Bë-së, si dhe në raportin screening të BE-së</p>	<p>Rregullimi i parimeve, si dhe mënyrës së krijimit, organizimit, funksionimit dhe tipologjisë së institucioneve të administratës shtetërore. Gjithashtu, në këtë ligj duhet të përcaktohet mekanizimi i mbikqyrjes së performancës së institucioneve të administratës shtetërore, si dhe raportimi në Këshillin e Ministrave në lidhje me zbatimin e ligjit.</p>	Po PKIE 2024 - 2026	N/A	<p>Strategjia Ndërsëktoriale e Reformës në Administratën Publike, 2023 - 2030, që pritet të miratoahet brenda vitit 2023</p>	Jo



Ministria e Arsimit dhe Sportit

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik "Fulbright"	Projektligji	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katër mujori I	Qëllimi i këtij projektligji është të forcojë dhe të zhvillojë lidhjet ndërmjet pjesëmarrësve në procesin e zbatimit të Programit të Shkëmbimit Akademik Fulbright në arsim, kulturë, shkencë dhe punë kërkimore, bazuar në kushte me përfitim të ndërsjellë ndërmjet palëve. Gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, synohet të koordinohet menaxhimi i Programit "Fulbright" në Republikën e Shqipërisë, organizimi i përzgjedhjes fillestare të kandidatëve për Programin "Fulbright", zhvillimi i aktiviteteve mësimore dhe shkencore, si dhe analiza e potencialit për shkëmbime akademike shtesë.	Nëpërmjet këtij projektligji synohet rinovimi dhe përditësimi i ligjit nr. 93/2019, "Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik "Fulbright", afati i vlefshmërisë së të cilit përfunon në vitin 2024, nxitja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dy vendet dhe inkurajimin e përmirësimit të kualifikimeve të profesionistëve akademikë, studiuesve, pedagogëve dhe studentëve, si dhe nxitjen e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore, ndërmjet palëve.	Jo	Po. Fusha e arsimit.	Jo	Po, ka efekte financiare dhe sociale, por nuk ka efekte mjedisore.
2	"Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"	Projektligji	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katër mujori I	Ky projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Kjo marrëveshje është miratuar në parim nëpërmjet vendimit nr. 354, datë 7.6.2023 të Këshillit të Ministrave për "Miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor". Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë	Ky projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Kjo marrëveshje është miratuar në parim nëpërmjet vendimit nr. 354, datë 7.6.2023 të Këshillit të Ministrave për "Miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor". Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë	Jo	Po. Fusha e arsimit.	Jo	Po, ka efekte financiare dhe sociale, por nuk ka efekte mjedisore.



					dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, është nënshkruar më 5 Korrik 2023 nga palët. Me anë të kësaj marrëveshjeje synohet forcimi i marrëvdhënieve ndërmjet dy shteteve përmes bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe interesi për të zhvilluar bashkëpunimin arsimor dhe shkencor me përfitim reciprok.	dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, është nënshkruar më 5 Korrik 2023 nga palët. Me anë të kësaj marrëveshjeje synohet forcimi i marrëvdhënieve ndërmjet dy shteteve përmes bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe interesi për të zhvilluar bashkëpunimin arsimor dhe shkencor me përfitim reciprok.				
3	"Për disa ndryshime në vendimin nr. 789, datë 15.12.2021 të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori I	Hartimi i projektvendimit, "Për disa ndryshime në vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 15.12.2021 "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre", propozohet për të mundësuar përcaktimin dhe kategorizimin sa më të qartë të përfituesve të statusit të sportistit elitar.	Rishikimi i kriterëve dhe kategorizimi i sporteve lidhur me qartësimin e procedurave për dhënie të statusit të sportistit elitar, ku të përcaktohet roli i analizave të dopingut në aktivitete ndërkombëtare dhe kombëtare.	Jo	Po. Fusha e Sportit.	Jo	Po ka efekte financiare dhe sociale, por nuk ka efekte mjedisore.
4	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 255, datë 09.05.2018, të Këshillit të Ministrave, "Përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Sportit"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori I	Përditësimi në lidhje me ndryshimin e përbërjes strukturore të Këshillit, me qëllim përcaktimin për përfaqësimin e institucioneve të cilat merren me hartimin dhe zhvillimin e politikave në fushën e sportit.	Përditësimi në lidhje me ndryshimin e përbërjes strukturore të Këshillit, me qëllim përcaktimin për përfaqësimin e institucioneve të cilat merren me hartimin dhe zhvillimin e politikave në fushën e sportit.	Jo	Po. Fusha e Sportit.	Jo	Po ka efekte financiare. Nuk ka efekte mjedisore.
5	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori I	Hartimi i këtij projektvendimi ka si qëllim t'u vijë në ndihmë personelit akademik dhe institucioneve të arsimit të lartë, për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave dhe standardeve shtetërore për fitimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë, me synim përmirësimin e cilësisë së arsimit që ofrojnë IAL-të publike dhe jopublike për studentët dhe shoqërinë në tërësi.	Hartimi i këtij projektvendimi ka si qëllim t'u vijë në ndihmë personelit akademik dhe institucioneve të arsimit të lartë, për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave dhe standardeve shtetërore për fitimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë, me synim përmirësimin e cilësisë së arsimit që ofrojnë IAL-të publike dhe jopublike për studentët dhe shoqërinë në tërësi.	Jo	Po. Fusha e arsimit.	Jo	Mund të ketë efekte financiare dhe sociale, por nuk ka efekte mjedisore.
6	"Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori I	Ky projektvendim ka për qëllim realizimin e një funksionimi sa më të mirë të Qendrës së Botimeve për Diasporën (QBD), si	Ky projektvendim ka për qëllim realizimin e një funksionimi sa më të mirë të Qendrës së Botimeve për Diasporën (QBD), si	Jo	Po. Fusha e arsimit.	Eshtë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Diasporës (2021-2025), miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.	Po, ka efekte financiare dhe sociale, por nuk ka efekte mjedisore.



					institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për mundësimin e ruajtjes, zhvillimit dhe mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, përmes botimit, sigurimit të teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese, si dhe mbështetjen e aktiviteteve për zhvillimin profesional të mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.	institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për mundësimin e ruajtjes, zhvillimit dhe mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, përmes botimit, sigurimit të teksteve mësimore dhe materialeve plotësuese, si dhe mbështetjen e aktiviteteve për zhvillimin profesional të mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.			585, datë 22.7.2020, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe të planit të veprimit 2021–2025". Trajtohet zhvillimi profesional i mësuesve të diasporës dhe miratimi i teksteve të përbashkëta për diasporën.	
7	"Për caktimin e kritereve të posaçme dhe procedurave për fitimin e statusit "shkollë me status të veçantë""	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori I	Projektvendimi ka për qëllim caktimin e kritereve për përfitimin e statusit "shkollë me status të veçantë" nga institucionet arsimore parauniversitare publike të arsimit të orientuar të cilat do të gëzojnë strukturë organizimi, kurrikul dhe mënyrë financimi të ndryshme nga institucionet arsimore parauniversitare publike.	Nëpërmjet këtij projektvendimi, synohet gjithëpërfshirje dhe barazi për të gjithë nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar, duke krijuar kushte, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, aftësi, talente të veçanta, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë.	Jo	Po. Fusha e arsimit.	Ky projektvendim është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" (SKA 2021-2026)	Po, mund të ketë efekte financiare dhe sociale, por jo efekte mjedisore.
8	"Për kriteret dhe procedurat për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve të arsimit special në qendra burimore, si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tyre"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori I	Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve arsimore publike parauniversitare të arsimit special në qendra burimore, si institucione që ofrojnë arsim special dhe shërbime të veçanta mbështetëse dhe rehabilituese për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK), si dhe të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.	Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet gjithëpërfshirja dhe arsimimi sa më cilësor i nxënësve me aftësi të kufizuara, duke u mbështetur edhe me shërbime të specializuara rehabilituese nga qendrat burimore.	Jo	Po. Fusha e arsimit.	Ky projektvendim është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" (SKA 2021-2026)	Po, ka efekte financiare dhe sociale, mund të ketë efekte mjedisore.
9	Rishikimi i vendimit nr. 99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar"	Projektvendim	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori I	Rishikimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar për përmirësimin e cilësisë në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.	Rishikimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar për përmirësimin e cilësisë në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.	Jo	Po. Fusha e Arsimit.	Po, lidhet me Strategjinë Kombëtare për Arsimin, miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj".	Po, ka efekte financiare dhe sociale, por nuk ka efekte mjedisore.
10	"Për Shkencën në Republikën e Shqipërisë"	Projektligj	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori II	Ky projektligj ka për qëllim të krijojë kushte për zhvillimin dhe funksionimin e një sistemi bashkëkohor të	Projektligji synon arritjen e objektivave si më poshtë: Sigurimin e produkteve të kërkimit shkencor që	Po- Në aspektin e integritimit në BE, projektligji është në koherencë të plotë me	Po. Fusha e Arsimit.	Po, lidhet me Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin, miratuar me	Po, ka efekte financiare dhe sociale, por nuk



				<p>shkencës dhe të garantojë mundësimin e financimit të këtij sistemi nga burime të ligjshme.</p> <p>Projektligji synon arritjen e objektivave si më poshtë: Sigurimin e produkteve të kërkimit shkencor që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, si dhe konsolidimin e identitetit dhe mbrojtjen e interesave kombëtare;</p> <p>përvetësimin e aftësive dhe njohurive të reja, transferimin e tyre për përfitimim e përgjithshëm publik, me synim rritjen e mirëqenies sociale;</p> <p>fuqizimin e aftësive për të menaxhuar progresin teknologjik dhe të përgjithshëm shoqëror, si burimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm, duke rritur vlerën e punës dhe konkurrueshmërinë; fuqizimin e lidhjeve ndërkombëtare të komunitetit të studiuesëve shqiptarë me ato të zonës europiane të kërkimit, si dhe me kërkuesit e diasporës, duke promovuar lëvizshmërinë dhe përfshirjen në proceset e integritimit evropian dhe në rrjetet ndërkombëtare të vlerave; ngritjen e kapaciteteve të personelit shkencor dhe nxitjen e zhvillimit të karrierës shkencore duke siguruar mundësi të barabarta; rritjen e përdorimit të infrastrukturës kërkimore shkencore duke garantuar akses për të gjithë; fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e kërkimit shkencor, me qëllim zhvillimin dhe shfrytëzimin e potencialeve kërkimore-shkencore;</p> <p>nxitjen e bashkëpunimit midis institucioneve të kërkimit - shkencor dhe biznesit, institucioneve publike, shoqërisë civile, si dhe palëve të tjera të interesuara në veprimtari kërkimore shkencore dhe inovacion promovimin, zgjerimin e rolit</p>	<p>mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, si dhe konsolidimin e identitetit dhe mbrojtjen e interesave kombëtare; përvetësimin e aftësive dhe njohurive të reja, transferimin e tyre për përfitimim e përgjithshëm publik, me synim rritjen e mirëqenies sociale; fuqizimin e aftësive për të menaxhuar progresin teknologjik dhe të përgjithshëm shoqëror, si burimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm, duke rritur vlerën e punës dhe konkurrueshmërinë; fuqizimin e lidhjeve ndërkombëtare të komunitetit të studiuesëve shqiptarë me ato të zonës europiane të kërkimit, si dhe me kërkuesit e diasporës, duke promovuar lëvizshmërinë dhe përfshirjen në proceset e integritimit evropian dhe në rrjetet ndërkombëtare të vlerave; ngritjen e kapaciteteve të personelit shkencor dhe nxitjen e zhvillimit të karrierës shkencore duke siguruar mundësi të barabarta; rritjen e përdorimit të infrastrukturës kërkimore shkencore duke garantuar akses për të gjithë; fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e kërkimit shkencor, me qëllim zhvillimin dhe shfrytëzimin e potencialeve kërkimore-shkencore;</p> <p>nxitjen e bashkëpunimit midis institucioneve të kërkimit - shkencor dhe biznesit, institucioneve publike, shoqërisë civile, si dhe palëve të tjera të interesuara në veprimtari kërkimore shkencore dhe inovacion promovimin, zgjerimin e rolit të shkencës dhe krijimin e një mjedisi favorizues dhe mbështetës për kërkimin shkencor në shoqëri.</p>	<p>parimet e përcaktuara në Dispozitat e Traktatit mbi Funksionimin e BE (TFBE), kapitulli XIX, mbi kërkimin shkencor. Gjithashtu, projektligji ka për qëllim plotësimin e detyrimeve që burojnë nga procesi i asociimit të BE lidhur me kapitullin 25 "Shkenca dhe kërkimi shkencor".</p>		<p>vendimin nr. 542, datë 20.9.2023 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj".</p>	<p>ka efekte mjedisore.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	-----------------------------



					të shkencës dhe krijimin e një mjedisi favorizues dhe mbështetës për kërkimin shkencor në shoqëri.					
11	Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kolegjit të Evropës "Për hapjen e Filialit të Kolegjit të Evropës në Tiranë"	Projektligj	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori II	Hapjen e Filialit të Kolegjit të Evropës në Tiranë.	Kolegji, një institut i studimeve evropiane i njohur për përsosmërinë e tij akademike dhe përkushtimin në promovimin e integritimit evropian, aspiron të shtrijë aktivitetet e tij akademike në Republikën e Shqipërisë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Duke marrë në konsideratë se më datë 6 tetor 2023 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit, ndërmjet Kolegjit të Evropës, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkisë së Tiranës, me qëllim rritjen e efikasitetit të ndërvëprimit ndërmjet Palëve për funksionimin sa më efektiv të bashkëpunimit dhe përmirësimit të veprimtarisë së tyre në kuadër të hapjes dhe funksionimit të Filialit të Kolegjit të Evropës në Tiranë, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kolegji i Evropës, duke njohur vlerën për progresin e arsimit të lartë në integrimin e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian (BE), shprehin vullnetin e përbashkët për hapjen e Filialit të Kolegjit të Evropës në Tiranë.	Jo	Po. Fusha e Arsimit.	Po, lidhet me Strategjinë Kombëtare për Arsimin, miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj". Objektivi specifik C.6: Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë.	Po ka efekte financiare dhe sociale por nuk ka efekte mjedisore.
12	"Për disa shtesa dhe ndryshime me Ligjin nr.79/2017 "Për sportin", i ndryshuar"	Projektligj	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori III	Hartimi i projektligjit, "Për disa shtesa dhe ndryshime me Ligjin nr.79/2017 "Për sportin", i ndryshuar," vjen si nevojë e rishikimit të politikave në fushën e sportit dhe si kërkesë e vazhdueshme e komunitetit të sportit për rishikimin e tij.	Rishikimi i kompetencave të sportit shkollor dhe universitar, rishikimi i mënyrës së financimit të organizatave sportive, përfshirja e Komitetit Paraolimpik në ligj, përfshirja e programit olimpiq special etj.	Jo	Po. Fusha e Sportit.	Jo	Po, ka efekte financiare, mund të ketë efekte sociale, por nuk ka efekte mjedisore
13	"Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS IV)"	Projektligj	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori III	Ratifikimi i marrëveshjes ndërkombëtare që përcakton detyrime financiare vjen në zbatim të nenit 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe është një detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 17 të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me	Nëpërmjet kësaj marrëveshje synohet të nxitet programi i shkëmbimit të studentëve, personelit akademik, kërkuesve shkencor duke garantuar bursa për të promovuar lëvizjen dhe bashkëpunimin ndërmjet universiteteve në Evropën Qendrore.	Jo	Po. Fusha e Arsimit.	Jo	Po ka efekte financiare dhe sociale por nuk ka efekte mjedisore.



					përfundimin e procedurave për miratimin në parim të marrëveshjes ndërkombëtare dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes vijon procedura ratifikuese e saj me ligj					
14	"Për ratifikimin e marrëveshjes "Për njohjen e kualifikimeve profesionale të infermierëve, veterinerëve, farmacistëve dhe mamive në kontekstin e marrëveshjes së Tregëtisë së Lirë të Evropës Qendrore".	Projektligji	Ministri i Arsimit dhe Sportit	Katërmujori III	<p>Qëllimi i këtij projektligji është ndjekja e procedurave të miratimit të marrëveshjes, "Për njohjen e kualifikimeve profesionale të infermierëve, veterinerëve, farmacistëve dhe mamive në kontekstin e Marrëveshjes së Tregëtisë së Lirë të Evropës Qendrore".</p> <p>Nëpërmjet miratimit të kësaj marrëveshjeje synohet përcaktimi i rregullave për njohjen automatike të dëshmime të kualifikimeve formale bazuar në kushtet minimale të trajnimit brenda Palëve për akses dhe ushtrim të profesionit të rregulluar, si dhe kushtet minimale të harmonizuara të trajnimit në një ose më shumë palë të tjera dhe që lejojnë mbajtësit e kualifikimit të ndjekin të njëjtin profesion në një palë të ndryshme nga pala ku ata kanë marrë kualifikimet e tyre profesionale.</p>	Nëpërmjet miratimit të kësaj marrëveshjeje synohet përcaktimi i rregullave për njohjen automatike të dëshmime të kualifikimeve formale bazuar në kushtet minimale të trajnimit brenda Palëve për akses dhe ushtrim të profesionit të rregulluar, si dhe kushtet minimale të harmonizuara të trajnimit në një ose më shumë Palë të tjera, dhe që lejojnë mbajtësit e kualifikimit në fjalë të ndjekin të njëjtin profesion në një Palë të ndryshme nga Pala ku ata kanë marrë kualifikimet e tyre profesionale.	Ky projektvendim nuk lidhet me çështjet e përafërimit të legjislacionit me acquis të BE-së. Marrëveshja është pjesë e Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor (MAP REA), në kuadër të Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal, i cili bazohet në arritjet e Zonës Ekonomike Rajonale (REA) si iniciativa e parë rajonale e këtij lloji. Plani i Veprimit përbëhet nga veprime të synuara në katër fusha kryesore: zona e tregëtisë rajonale, zona rajonale e investimeve, zona dixhitale rajonale, zona rajonale industriale dhe inovative. Marrëveshja është pjesë e zonës së tregëtisë së lirë rajonale e cila do të sigurojë lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe të profesionistëve.	Po. Fusha e Arsimit	Jo	Po ka efekte financiare dhe sociale por nuk ka efekte mjedisore.



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2024

Ministria e Brendshme

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10123, datë 11.05.2009, "Për Gjendjen Civile"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ligji ka nevojë për rishikim në të gjithë nenet e vendbanimit dhe shërbimit të gjendjes civile ndaj shtetasve, në vijim të kalimit të shërbimeve online.	Ky projektvendim synon të rregullojë mënyrën e ofrimit të shërbimeve të gjendjes civile ndaj shtetasve, në vijim të kalimit të shërbimeve publike online.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2024	Jo	Jo
2	"Për disa ndryshime në ligjin nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Përmirësimin ligjit organik duke qartësuar dhe rritur rolin e prefektit të qarkut.	Projektligji ka si qëllim rritjen e rolit të prefektit të qarkut duke saktësuar mënyrën e verifikimit të realizimit të funksioneve nga ana e pushtetit vendor, të përgjegjësisë të deleguara nga pushteti qendror dhe përdorimin e fondeve të parashikuara për këto funksione.	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2024	Ndërthuret me Strategjinë e Decentralizimit dhe Vetëqeverisjes Vendore	Jo
3	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.07.2004, "Për sistemin e adresave"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ligji ka nevojë për rishikim në nenet e përcaktimit të Regjistrin Kombëtar të Adresave, ndërlidhjes me institucione të tjera. Po ashtu është i nevojshëm rishikimi i akteve nënligjore për sinjalistikën e adresave.	Propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 synohen të realizohen përmes rishikimit kryesisht të parashikimeve për Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA), sa i takon adresimit të të gjithë ndërtesave shtetërore, konkretisht përmes: -Ndërtimit të regjistrit të ndërtesave në RKA; - Detyrimit të institucioneve për deklarimin e adresës në RKA; - Ndërtimit të regjistrit të institucioneve në RKA. Gjithashtu, synohet shtimi i pikave të interesit në RKA, përmes: -Propozimit të ndryshimeve ligjore për detyrimin e zyrave të urbanistikës për vendosjen e pikave të interesit; - Ndërtimit të regjistrit të pikave të interesit për të regjistruar spitalet, rajonet e policisë, bashkitë, muzetë etj; -Regjistrimit të institucioneve të emergjencave në RKA (Policia, Zjarrfikësja, Spitale etj.)	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2024	Jo	Jo
4	"Për përcaktimin e rregullave, llojeve dhe procedurave për ofrimin e Shërbimit Shtetëror të Gjendjes Civile"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ligji nr. 134/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10192, datë 11.05.2009 "Për gjendjen Civile", i ndryshuar, neni 61, pika 4, autorizon Këshillin e Ministrave për të përcaktuar rregullat, llojet dhe procedurat për	Format e ofrimit të shërbimit të gjendjes civile, llojet dhe procedurat për ofrimin e këtij shërbimi	Jo	Përputhet me prioritetet e Ministrisë së Brendshme për vitin 2024	Jo	Jo



					ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni.						
5	"Për përcaktimin e kriterëve dhe masës së përfuturit të pagesës së qirasë për strehim për punonjësit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Projektvendimi ka për qëllim zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore", për miratimin e akteve nënligjore në lidhje me kompensimin e qirasë së banesës, kur punonjësi i Agjencisë transferohet jashtë vendbanimit të përhershëm, brenda ose jashtë vendit.	Projektvendimi synon sigurimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së punonjësve, nëpërmjet pagesës dhe kompensimit të shpenzimeve të strehimit, të cilët transferohen në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm, dhe nuk u sigurohet nga Agjencia, mjedisi për akomodim.	Jo	Përputhet me prioritetet e Ministrisë së Brendshme për vitin 2024	Jo	Po	
6	"Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Në vijim të përfundimit të periudhës kohore të zbatimit të strategjisë aktuale, lind nevoja për hartimin e strategjisë së re dhe planit të veprimit. Neni 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.	Në vijim të përfundimit të periudhës kohore të zbatimit të strategjisë aktuale, lind nevoja për hartimin e strategjisë së re dhe planit të veprimit. Neni 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.	Jo	Përputhet me prioritetet e Ministrisë së Brendshme për vitin 2024	Jo	Jo	
7	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Parë në optikën e zhvillimeve dhe të problematikës së shfaqur në kuadër të përmirësimeve në strukturën e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, gjatë periudhës rreth 7 vjeçare (2016-2023), periudhë në të cilën shërbimi i MZSH-së ka kaluar dhe vazhdon të jetë në varësi të kryetarit të bashkisë, evidentohet fakti për përmirësime rregullatore	Projektligji duhet të parashikojë nevojën për forcimin e koordinimit, përditësimin teknologjik dhe rritjen e kapaciteteve operacionale në veprimet e parashikimit, parandalimit dhe luftimit aktiv të zjarreve, kryesisht në pyje, si dhe nxitjes së investimeve për sigurinë e territorit, përmirësimin dhe standardizimin e kriterëve për rekrutimin e punonjësve në nivel bazë dhe të mesëm të shërbimit të MZSH-së.	Jo	Përputhet me prioritetet e Ministrisë së Brendshme për vitin 2024	Jo	Jo	
8	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 71/2016, "Për kontrollin kufitar", të ndryshuar.	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrimi buron nga rregullorja	Rregullimi i çështjeve të lindura, sipas nevojave dhe problematikave të evidentuara, rishikimi i aktit në raport me legjislacionin në fuqi, si dhe acquinë e Bashkimit Evropian	Po	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt, si dhe me prioritetet e Ministrisë së Brendshme për vitin 2024	Projektakti lidhet me Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Kufirit	Po	
9	"Për miratimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet në bazë të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026".	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Përfundimi i afatit aktual të Planit të Veprimit të Strategjisë së Sigurisë në Komunitet. Përbushja e objektivave të Strategjisë e cila është e miratuar deri në vitin 2026.	(1) Rritja e parametrevë të sigurisë në komunitet. (2) Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin. (3) Reformimi i Shërbimit Policor dhe Rritja e kapaciteteve për Sigurinë në Komunitet.	Jo	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	VKM Nr. 1139, datë 24.12.2020	"Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026".	Po
10	"Për miratimin e Planit të Veprimit të Strategjisë të Menaxhimit të Integruar të Kufirit në bazë të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027".	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Përfundimi i afatit aktual të Planit të Veprimit të Menaxhimit të Integruar të kufirit. Përbushja e objektivave të Strategjisë e cila është e miratuar deri në vitin 2027.	(1) Mbrojtja e sigurisë së brendshme dhe menaxhimi i flukseve migratore, me qëllim parandalimin e migracionit të parregullt, si dhe parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar. (2) Lehtësimi i qarkullimit legal të shtetasve dhe mallrave. (3) Respektimi i plotë i të drejtave themelore, përfshirë trajtimin e çdo individi me respekt të plotë për dinjitetin dhe mundësimin e qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare të atyre që kanë nevojë	Po	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	VKM nr. 1117, datë 16.12.2020 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2022-2027"	Po	



11	"Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Përfundimi i afatit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023 (VKM nr. 670, datë 10.11.2021). Përbushja e objektivave të Strategjisë e cila është e miratuar deri në vitin 2027.	Plani i Veprimit përbën dokumentin më të rëndësishëm politik dhe strategjik të vendit në fushën e antitrafikimit. Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023, por të përshtatura me dinamikën e trafikimit, vizionin e ri qeverisës në qasjen ndaj fenomenit të trafikimit për të krijuar një platformë të mirëorientuar synimesh e objektivash strategjike në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.	Jo	Po, shtylla: Shqipëria e fortë, fusha: Shqipëria e Sigurt	Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e saj të Veprimit 2023-2025	Po
12	"Për përcaktimin e procedurave të krijimit të regjistrit elektronik, bazë të dhënash shtetërore, kriteret, mënyra dhedokumentacioni për kërkesën për ID digjitale të rezidentit elektronik, përfshirë përpunimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Ligji nr. Ligjit Nr. 43/2023 "Për Qeverisjen Elektronike", ne nenin 40, pika 4, parashikon se Procedura e krijimit të regjistrit elektronik, bazë të dhënash shtetërore, kriteret, mënyra dhedokumentacioni për kërkesën për ID digjitale të rezidentit elektronik, përfshirë përpunimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civil	Regjistri elektronik, procedurat e krijimit, kriteret, mënyra dhedokumentacioni për kërkesën për ID digjitale të rezidentit elektronik, përfshirë përpunimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave	Jo	Përputhet me Prioritet e Brendshme të vitit 2024	Jo	Po
13	"Për sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Ky projektvendim parashikon shërbimet shëndetësore, autoritetin mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe përfituesit, në zbatim të pikës 3, të nenit 71, të ligjit nr. 128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore".	Ky projektvendim parashikon shërbimet shëndetësore, autoritetin mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe përfituesit, në zbatim të pikës 3, të nenit 71, të ligjit nr. 128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore".	Kapitulli 23 Gjyqësori dhe të drejtat themelore Lufta kundër korrupsionit	Përputhet me Prioritet e Brendshme të vitit 2024 II.2. Lufta kundër korrupsionit	Jo	Po
14	"Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Direktiva BE 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit Europian datë 27.04.2016 mbi perdorimin e të dhënave të regjistrit të emrit të pasagjerit (PNR) me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave me qëllime terroriste dhe krime të rënda. Direktiva e Këshillit 2004/82/KE, datë 29 prill 2004, "Për detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët" Amendimi i ligjit nr. 22/2020 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar" dhe miratimi i ligjit për API/PNR në fakt janë pjesë përbërëse të të njëjtit akt, pasi Ligji 22/2020 hiqet si pjesë përbërëse nga Ligji 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar" dhe krijohet si ligj më vete, sipas kërkesave të Direktivave të BE-	Ligji i ri synon përputhjen e plotë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ligji i ri për Mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë ende nuk është aprovuar, por pritet të dorëgohet në parlament se shpejt, dhe është parë e arsyeshme që të shtyhet afati për ndryshimin e Ligjit 22/2020 dhe aprovimin e Ligjit të ri për API/PNR në vitin 2024 për shkak të procedurave që kërkon hartimi dhe aprovimi i një ligji të ri	Po, Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po



					së për të dhënat API dhe të dhënat PNR					
15	"Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Nevoja për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve.	Ngritja e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, përcaktimi i mënyrës së funksionimit, kompetencave dhe përgjegjësi të kësaj zyre, si dhe mënyra e bashkëpunimit me institucionet e tjera, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së saj.	Po, Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2024	Jo	Po
16	"Për Policinë e Shtetit"	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Problematika të evidentuara nga praktika	Projektligji synon rishikimin në tërësi të rregullimeve ekzistuese, duke përfshirë rishikimin e disa procedurave që lidhen me rekrutimet e personelit të Policisë së Shtetit, të drejtat e tyre, statusin, rishikimin e sistemit Gradave në përputhje me pozicionin e punës.	Jo	Po, shtylla: Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Jo	Po
17	"Për përcaktimin e procedurave të trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës së Shqipërisë"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Ky projektvendim rrit shkallën e motivimit në punë të punonjësve, në funksion të realizimit të misionit të përcaktuar me ligj.	Projektvendimi synon të mbështesë financiarisht punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë me qëllim shpërblym dhe motivim të punonjësve që përmbushin me sukses misionin e tyre.	Jo	Përputhet me prioritetet e Ministrisë së Brendshme për vitin 2024	Jo	Po
18	"Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 332, datë 17.03.2010, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e formës, elementeve përbërës, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile", të ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Reformat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për digjitalizimin e shërbimeve	Miratimi i dokumentave elektronike	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2024	Jo	Jo
19	"Për sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Ky projektvendim përcakton shërbimet shëndetësore, autoritetin mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe strukturat e veçanta që përfitojnë, në zbatim të pikës 3, të nenit 49, të ligjit nr. 33/2021, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë".	Ky projektvendim përcakton shërbimet shëndetësore, autoritetin mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe strukturat e veçanta që përfitojnë, në zbatim të pikës 3, të nenit 49, të ligjit nr. 33/2021, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë".	Jo	Përputhet me Prioritet e Ministrisë së Brendshme të vitit 2024	Jo	Po



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2024
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.10465/2011 "Per sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise"	Projektligj	Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rura	Katërmujori I	Plotësimi I mangësive ligjore të evidentuara në fushes se menaxhimit te mbejteve ne Shqiperi dhe fushes se produkteve mjekesore veterinare	Plotësimi i kuadrit ligjore lidhur me menaxhimit të mbejteve, duke përcakuar kriteret e licensimit dhe rregullat që duhen të plotesojnë operatoret që grumbullojnë keto nënprodukte. Ndryshim ne fushën e produkteve mjekesore veterinare duke rregulluar fushen e prodhuesve vendas në përputhje me rregulloren 2019/6. Ligji do te qartesojë me mirë strukturat kompetente në linje me legjislacionin e BE-se dhe do të permbush përcaktimet e nenit 127 te ketij ligji për një shërbim veterinar funksional dhe me varesi vertikale. Gjithasht ndryshimet ligjore do të bëjnë të mundur marjen e masave kufizuese ndaj importit jo vetëm nga njoftimet që vijnë nga Organizata Boterore e Shendetit te Kafsheve por edhe nga sistemi i informacionit të sëmundjeve të kafsheve në BE.	Jo	Jo	Jo	po, ndikime ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore
2	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar	Projektligj	Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Përafrim i legjislacionit të BE-së	Synon rregullimin e disa dispozitave në përputhje me rekomandimet e lëna nga takimi bilateral	Po, kapitulli 13	Jo	Po, strategjia e bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021-2027	Po
3	Për miratimin e rregullave për prodhimin, tregtimin, ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese	Projektvendim	Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori i	Plotesim i Ligjit nr. 17/2020, datë 17.2.2020, "Për produktet plehëruese" me akte nenligjore sipas pikës 4, të nenit 17.	Percaktimi i rregullave konkrete dhe te detajuar ne procesin e prodhimit, tregtimit, perfshire dhe etiketimin dhe aspektet e tjera.	Jo	JO	Jo	Po, ekonomike
4	Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.613, date 27.10.2017 " Per miratimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore te cilat i kajan e ne pergjegjesi administrimi MBZHR-se, per Drejtorine e Sherbimeve te Peshkimit dhe Akuakultures" te ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori i	Aktet me karakter teknik ne zbatim te Ligjit nr.64/2012 "Per peshkimin" te ndryshuar.	Akt me karakter teknik per DSHPA institucioni i percaktuar nga ligji si institucion menaxhues.	Jo	Jo	Jo	Jo
5	Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024	Projektvendim	Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Mbështetje për fermerët dhe subjektet në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural; mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi; vijimi i trajnimeve nga UBT	Përcaktimi I masave të mbështetjes kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2024, kriteret baze4	Jo	Zhvillimi I Bujqësisë dhe Fshatit; Rritja e mbështetjes ë	Po, Strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit, 2021–2027	Po, nga buxheti i parashikuar për vitin 2024 për MBZHR-në



							Bujqësi, Blegtori dhe Zhvillim Rural			
6	"Për procedurat, dokumentacionin dhe kriteret për përfundimin e procesit të privatizimit dhe kalimit në pronësi të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore",	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural/MFE	Katërmujori I	Synohet plotësimi i ligjit 18/2023 "Për përfundimin e proceseve të privatizimit të ish-ndërmarrjeve bujqësore"aktet nenligjore	Të përcaktojë procedurën, dokumentacionin, kushtet, mënyrën e përlogaritjes së vlerës së pagesës së mbetur dhe afatet e shlyerjes së saj për objektet e ish-ndërmarrjeve Bujqësore, për të cilat ka filluar procesi i privatizimit nga Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, kjo në zbatim të parashikimeve të Ligjit 18/2023	Jo	Jo	Jo	Jo
7	Kriteret mbi përdorimin e tokës bujqësore për kryerjen e aktivitetit agrifotovoltaik sipas përcaktimeve të këtij neni dhe atij eolik në tokat bujqësore me bonitet deri në 8, procedurat për monitorimin e ushtrimit të aktivitetit përfshirë masat për shkelje të kushteve të ushtrimit të aktivitetit, si dhe tarifën që paguajnë subjektet që tregtojnë energjinë e prodhuar në centralet e energjisë së rinovueshme agrifotovoltaike në toka bujqësore.	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rura	Katërmujori I	Synohet plotësimi i ligjit Nr.68/2023 me aktet nenligjore	Projektvendimi krijon bazën rregulatore të kryerjes së aktiviteteve të njëkohshme, bujqësi dhe prodhim energji të rinovueshme.	Jo	Jo	Jo	Jo
8	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes në lidhje me kredinë për "Programin Ekonomia Blu" ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Qeverisë së Republikës Italiane përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar".	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Miratimin në parim të marrëveshjes së dakordësuar me palën italiane me qëllim nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje për financimin me 25 000 000 Euro për Programin "Ekonomia Blu".	Miratimi në parim i Marrëveshjes së Bashkëpunimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje me qëllim financimin prej 25,000,000 Euro për Programin "Ekonomia Blu" nga Qeveria e Republikës Italiane. Ky financim ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë detare dhe bregdetare shqiptare duke i ofruar institucioneve dhe sektorit privat mundësi të reja lidhur me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.	jo	Nuk lidhet drejtëpërdrejtë me këtë program por do të sjellë ndikime në zhvillimin e zonave bregdetare, përdorimin e qëndrueshëm të tyre për rritjen ekonomike, përmirësimin e jetesës dhe punësimin, duke garantuar ruajtjen e ekosistemeve detare.	po, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022–2030 Strategjinë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 – 2027, konkretisht me Politikën nr. 2 "Zhvillimi i qëndrueshëm i peshkimit dhe ekonomisë blu	po
9	Rregulla të hollësishme për marrjen e masave parandaluese për përhapjen e zjarreve	projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori I	Synohet plotësimi i ligjit Nr.68/2023 me aktet nenligjore	Garantimi i mospërhapjes së zjarreve në rastet kur digjen mbetje bimore në toka bujqësore.	Jo	Jo	Jo	Jo
10	Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori II	Rregulloren (KE) 2018/848 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 30 maj 2018 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007. Numri CELEX: 32018R0848,	Qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë parimet dhe rregullat për prodhimin biologjik, lidhur me certifikimin dhe përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit biologjik në etiketimin dhe reklama, dhe rregullat për kontrollin zyrtar, që të sigurojë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit organik, funksionimin efikas të tregut të brendshëm dhe garantimin e konkurrencës së drejtë, besimit dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.	po, kapitulli 11	jo	po, Strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit, 2021–2027	po, ndikime ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore
11	"Për deftesat tregtare mbi produktet bujqësore	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori II	Krijimi i dy instrumentave të rinj financiar për fermeret me qellim kreditimin e tyre.	Krijon kolateral për fermeret me qellim kreditimin, dhe si kolateral	Jo	Jo	Jo	Jo



						lihet prodhimi bujqësor dhe prodhimi i ardhshëm.				
12	"Për kriteret dhe procedurat për dhënie me qira të sipërfaqeve toke jo bujqësore".	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori II	Plotesimi i Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", me aktet nenligjore. Hartimi do behet me ASHK dhe MFE, në grup pune në MBZHR.	Percaktimi i menyres së marrjes së tokës jo bujqësore të mbjell, nga poseduesit faktik, dhe rregullimi i cështjeve të pageses.	Jo	Jo	Jo	Jo
13	Për ngritjen e sistemit të inspektimit për parandalimin, shkurajimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (PPP) dhe krijimin e skemës së certifikimit të zënieve në peshkim	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Krijimi i sistemit të inspektimit me qëllim garantimin e peshkimit sipas legjislacionit në fuqi.	Synon rregullimin e disa dispozitave në përputhje me rekomandimet e lëna nga takimi bilateral	Po, kapitulli 13	Jo	Po, strategjia e bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021-2028	Po
14	Për përcaktimin e zonave të prodhimit të rrushit për verë, bazuar në të dhënat e studimit, për "Zonat e kultivimit të vreshtave për verë".	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Detyrim që rrjedh nga pika 6, neni 10, Ligji Nr. 86/2022; Baza për përcaktimin e varieteteve të rrushit për verë, sipas karakteristikave përkatëse të zonave të Shqipërisë; rritje e prodhimit dhe cilësisë së verës; rritje e të ardhurave	Përcaktimi i zonave të kultivimit të vreshtave për verë, bazuar në treguesit e tokës, klimës, etj	Jo	Zhvillimi i Bujqësisë dhe Fshatit; Zhvillimi i fshatit drejt turizmit rural; modernizimi për zhvillim	Po, strategjia e bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021-2028	po
15	Për përcaktimin e rregullave të funksionimit dhe detyrat e Këshillit Kombëtar të Vitivinikulturës	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Detyrim pika 3, neni 8, Ligji Nr. 86/2022; Rritja e transparencës së sektorit; përfshirja e grupeve të interesit në vendimarrje; zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit;	Këshilli Kombëtar i Vitivinikulturës, këshillon, informon dhe rregullon kur kërkohet, ndryshime ligjore ose rregullatore që ndikojnë drejtpërdrejt në vitivinikulturë; formulon propozime konkrete; përpilon rekomandime për planet e veprimit strategjik; propozon veprimet e nevojshme për promovimin e vitivinikulturës;	Jo	Zhvillimi i Bujqësisë dhe Fshatit	Po, strategjia e bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021-2028	Jo
16	Për përcaktimin e funksionimit, kohëzgjatjes, organizimit dhe detyrave të Komisionit të Verës	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Detyrim pika 5, neni 19, Ligji Nr. 86/2022	Krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Verës, që do të mundësojë ekzaminimin në substancë të specifikimeve të verërave me EO dhe TGJ; vlerësimin e kërkesave për verërat me term tradicional; vlerësimin e ndryshimeve për specifikimet e produktit me term tradicional; kundërshimet e kërkesave për ndryshimin e specifikimeve të verërave me term tradicional dhe verërave me EOM dhe TGJM; regjistrimin e emërtimeve me term tradicional	Jo	Zhvillimi i Bujqësisë dhe Fshatit	Po, strategjia e bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021-2028	Po Financiare (pagesa e komisionit)
17	Për shëndetin e bimeve	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Përfshirja e legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së për shëndetin e bimëve. Plotësimi i mangësive në ligjin ekzistues "Për mbrojtjen e bimëve", lidhur për përgatitjen e listës së dëmtuesve karantinorë, mungesën e përcaktimit të qartë të autoriteteve kompetente që krijojnë boshllëqe dhe mbivendosje të detyrave dhe përgjegjësi që lidhen me kontrollin dhe çrrënjosjen e dëmtuesve karantinorë dhe jo vetëm. Forcimi i mbrojtjes kundër dëmtuesve të bimëve është parakusht për të siguruar tregtim të sigurt, si dhe zbut ndikimet e	Miratimi i rregullave për përcaktimin e risqeve fitosanitare dhe garantimin e mbrojtjes së shëndetit të bimëve nëpërmjet parandalimit të hyrjes dhe përhapjes së dëmtuesve në territorin e vendit; Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve të përfshira nëpërmjet rregullimit të organizimit dhe funksionimit të shërbimit të shëndetit të bimëve;	PO, kapitulli 12	Jo	Jo	Po, Ndikim ekonomik Mjedisor, social



					ndryshimeve klimatike në shëndetin e të korrave dhe pyjeve	<p>Përkufizimi i dëmtuesve karantinorë dhe jo-karantinorë të rregulluar dhe përcaktimi i veprimeve dhe masave që duhet të ndërmerren për ndalimin dhe kontrollin e përhapjes për këto dëmtues;</p> <p>Masat në lidhje me importimin, tranzitin dhe lëvizjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera;</p> <p>Rregullimi i regjistrimit të operatorëve profesionistë dhe gjurmueshmërisë;</p> <p>Certifikimi i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera;</p> <p>Rritja e gatishmërisë dhe mbikëqyrjes për shpërthimin e dëmtuesve;</p> <p>Përmirësimi i instrumenteve për monitorimin, kontrollin dhe çrënjosjen e dëmtuesve;</p> <p>Rregullimi i kriterëve për pasaportat bimore dhe zonat e mbrojtura;</p> <p>Përmirësimi i standardeve dhe rritja e besimit në sistemin rregullator kombëtar për shëndetin e bimëve.</p>				
18	Për shëndetin e kafsheve	Projektligj	Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Perarim Rregullores(BE) 2016/429) për sëmundjet e transmetueshme të kafshëve. Përcakton qartë përgjegjësitë për fermerët, veterinerët dhe të tjerët që kanë të bëjnë me kafshët dhe lejon përdorimin më të madh të teknologjive të reja për aktivitetet e shëndetit të kafshëve - mbikëqyrjen e patogjenëve, identifikimin elektronik dhe regjistrimin e kafshëve, si dhe përcakton një bazë më të mirë ligjore për monitorimin e patogjenëve të kafshëve rezistente ndaj agjentëve antimikrobikë.	<p>prioritizimi dhe kategorizimi i sëmundjeve me interes të Unionit dhe për vendosjen e përgjegjësisë për shëndetin e kafshëve; zbulimin e hershëm, njoftimin dhe raportimin e sëmundjeve, mbikëqyrja, programet e çrënjosjes dhe statusi pa sëmundje; ndërgjegjësimi, gatishmëria dhe kontrolli i sëmundjeve; regjistrimin dhe miratimin e stabilimenteve dhe transportuesve, lëvizjen dhe gjurmueshmërinë e kafshëve, produkteve germinale dhe produkte me origjinë shtazore; hyrjen e kafshëve, produkteve germinale dhe produkteve të kafshëve origjinën; non-commercial movements of pet animals; masat emergjente që duhen marrë në rast të një situatë emergjente sëmundjeje</p>	PO, kapitulli 12	Politika e Sigurisë Agro-Ushqimore	Jo	po, ndikim Ekonomik, social dhe mjedisor
19	"Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislationit mbi ushqimin	Projektligj	Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Ky projekt ligj do të përafrohet pjesërisht me Rregulloren (BE) 2017/625 të Parlamentit Evropian dhe	Ky projekt ligj parashikon të përcaktoje rregullat për: a) kryerjen e kontrolleve zyrtare	po, kapitujt 11-12	Jo	Strategjia Kombetare e Sigurisë Ushqimore 2023-2027	po, ndikim ekonomik dhe financial



	dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”				Këshillit të datës 15 mars 2017. Ky projekt ligj përcakton rregullat e përgjithshme dhe të veçanta, parimet dhe kërkesat që lidhen me kontrollet zyrtare dhe veprimtaritë e tjera zyrtare, si dhe përcakton përgjegjësitë, financimin dhe procedurat për kryerjen e kontrolleve zyrtare me qëllim garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe të mjedisit në Republikën e Shqipërisë. Hartimi i këtij projekt ligji ka për qëllim unifikim e kontrolleve zyrtare sipas legjislacionit të BE-së, si dhe plotësimin e rekomandimeve të Raport-progreseve.	dhe veprimtari të tjera zyrtare nga institucionet përgjegjëse; b) financimin e kontrolleve zyrtare; c) miratimin dhe zbatimin e kushteve që duhet të përmbushin kafshët dhe mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga shtete që nuk janë shtete anëtare të BE-së; d) ngritjen e një sistemi informacioni të kompjuterizuar për të menaxhuar informacionin dhe të dhënat që i përkasin kontrolleve zyrtare;				
20	"Per disa ndryshime në ligjin Nr.10416 per Materialin Mbjelles dhe Shumezues Bimor"	Projektligj	Ministri i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Ky ligj do te permiresoje rregullat per sigurimin e cilesise se Materialit Mbjelles dhe Shumezues Bimor per Mbeshtetjen e Prodhimit Bujqesor, Mbrojtjen e mjedisit dhe konsumatorin	Ky ligj do te permiresoj rregullat per sigurimin e cilesise se Materialit Mbjelles dhe Shumezues Bimor per Mbeshtetjen e Prodhimit Bujqesor, Mbrojtjen e mjedisit dhe konsumatorin	Jo	po	Strategjia Kombetare e Sigurise Ushqimore 2023-2027	JO



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2024

Ministria e Drejtësisë

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar"	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori I	Miratimi i këtij projektligji diktohet nga nevoja për adresimin e disa çështjeve që janë evidentuar si problematike gjatë zbatimit të ligjit nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar", si dhe për afrimi me Direktivën 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procesin penal.	Ky projektligj synon të përmirësojë rregullat e ligjit të përkthimit zyrtar, nisur nga implementimi i tij në praktikë dhe problematikat e evidentuara gjatë aplikimit të këtyre rregullave ligjore, që të sigurojë shërbimin e përkthimit edhe për ato gjuhë për të cilat deri më tani nuk ka përkthyes zyrtar të certifikuar, si dhe të garantojë të drejtën e përkthimit në përputhje me Direktivën 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procesin penal.	Po/ Të drejtat e njeriut	Jo	PKIE	Po
2	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 6.2.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti"	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori I	Projektvendimi ka si qëllim rishikimin VKM nr. 55/2019, në kuadër të procesit të përfaqësjes së tij me Kodin e Procedurave Administrative si dhe me procesin e derregullimit duke ndryshuar rrënjësisht qasjen ndaj OJF-ve, duke lehtësuar procedurat dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit publik, duke thjeshtëzuar procedurat dhe lehtësuar barrën e tyre për marrjen e autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti lidhen me përputhshmërinë e disa prej dispozitave të VKM nr. 55/2019 me KPA, si dhe me heqjen nga lista e disa dokumenteve të cilat kërkohen të përcillen nga OJF	Jo	Jo	Jo	Jo
3	Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2023	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori I	Rekomandimet kanë për qëllim dhe synojnë garantimin e funksionimit efektiv të organit të prokurorisë, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, krimin të organizuar, dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të të drejtave të njeriut.	Përcaktimin e prioriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, në përbushje të detyrimeve të brendshme ligjore, si dhe rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare. Këto rekomandime prioritare i përcillen organit të prokurorisë në ushtrim të përgjegjësisë shtetërore të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, për ndjekjen dhe realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë	Jo	Jo	Jo	Jo



						dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit reciprok të pushteteve				
4	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër korrupsionit 2024 - 2030	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori II	Afati i Strategjisë dërsëktoriale kundër korrupsionit dhe planit të saj të veprimit përfundon në vitin 2023, është e nevojshme të miratohet strategjia e re anti-korrupsion në kuadër të koordinimit të prioritetëve dhe objektivave të vendosur në fushën antikorrupsion.	Planifikimi i objektivave kryesorë në luftën kundër korrupsionit për insitucionet përgjegjëse dhe masave zbatuese përkatëse	Po/Antikorrupsioni	Po	PKIE	Po
5	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Projektligji ka si qëllim përbushjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata Kushtetuese për plotësimin e ligjit lidhur me përlogaritjen e kamatave në rastet e akteve të dhënies së kredisë bankare ose detyrimeve monetare. Gjithashtu, synon nërmarrjen e masave legislative për të ulur numrin e çështjeve të prapambetura në gjykata.	Projektakti synon të rregullojë kryesisht mënyrën e përlogaritjes së kamatave për aktet për dhënie kredisë bankare ose detyrime monetare, varësisht nëse janë me natyrë tregtare apo konsumatore. Gjithashtu, synon të rregullojë çështjet të cilat shqyrtohen nga gjykatat me 1 ose 3 gjyqtarë, duke patur në konsideratë uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatë.	Jo	Jo	Jo	Po
6	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Nisma për miratimin e një Kodi të ri Penal ka filluar që në vitin 2020. Grupi i ekspertëve ka hartuar tashmë dokumentin final i cili në vijim duhet t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të konsultimit të gjërë publik dhe brenda vitit 2024 duhet të miratohet në Këshill të Ministrave.	Rregullimi i instituteve të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal në drejtim të respektimit të parimit të ligshmërisë dhe sigurisë juridike në përputhje me standardet evropiane, rishikimi i politikës penale në kuadër të arritjes së qëllimit të dënimit penale për rehabilitimin e personave dhe parashikimi i veprave penale në mënyrë të detajuar, bazuar në modelet më të mira evropiane, në përputhje me Konventat e detyrueshme për tu bzatuar nga Republika e Shqipërisë si dhe në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian, në të cilin Shqipëria aspiron të bëhet pjesë.	Po	Jo	Jo	Po
7	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Projektligji ka si qëllim ndërmarrjen e masave legislative për të ulur numrin e çështjeve të prapambetura në gjykata.	Projektakti synon të rregullojë kryesisht çështjet të cilat shqyrtohen nga gjykatat me 1 ose 3 gjyqtarë, duke patur në konsideratë uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatë, si dhe çështjet ndaj të cilave nuk mund të bëhet ankim apo rekurs.	Jo	Jo	Jo	Po
8	Për mbrojtjen e të dhënave personale	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Harmonizimi me acquis e BE, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680", si dhe zbatimi i standardeve të BE në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Përmirësimi i rregullave për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre.	Garantimi i standardeve më të larta evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në një kohë kur përpunimi i të dhënave personale në epokën digjitale është shumëfishuar. Qytetarëve u garantohet një nivel më i lartë kontrolli mbi të dhënat e tyre personale. Krijimi i një kuadri ligjor gjithpërfshirës, duke garantuar edhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me përpunimin e të dhënave nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla	Po/ Të drejtat e njeriut	Jo	PKIE	Po
9	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Kjo nismë ka si qëllim rihapjen e afatit për ish-të dënuarit politikë, të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e	Nisma synon të rihapë afatin për ish-të dënuarit politikë, të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e	Jo	Jo	Jo	Po



	politikë të regjimit komunist", të ndryshuar				bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore dhe plotësojnë kriteret. Nisur nga qëllimi i ligjit për dhënien e dëmshpërblimit financiar nga shteti shqiptar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist, si një angazhim i shtetit demokratik në dënimin e krimeve të regjimit totalitar komunist dhe garantimin për ta të një jete më të mirë, është vlerësuar rihapja e afatit për paraqitjen e kërkesave nga subjektet parësore.	subjekteve përfituese parësore dhe plotësojnë kriteret.				
10	Për ratifikimin e Protokollit për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Miratimi i këtij projektligji diktohet nga ndjekja e procedurës së parashikuar nga ligji nr.43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, me qëllim shprehjen e pëlqimit që Republika e Shqipërisë të jetë palë e Protokollit për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore.	Protokoll i mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ka si qëllim përcaktimin e ligjit të zbatueshëm për detyrimet ushqimore që rrjedhin nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesë ose lidhje tjetër jo gjinie, duke përfshirë detyrimin për ushqim në lidhje me një fëmijë, pavarësisht nga statusi martesor i prindërve. Ky Protokoll ka parashikuar disa rregulla të veçanta favorizuese ndaj disa përfituesve, si në rastet kur detyrimi për ushqim është nga prindërit ndaj fëmijëve të tyre, personave të tjerë, përveç prindërve, ndaj personave që kanë mbushur moshën 21 vjeç, fëmijëve ndaj prindërve të tyre, si dhe ndërmjet bashkëshortëve ose ish-bashkëshortëve. Miratimi i këtij projektligji do të ndikojë edhe në nxitjen e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke qenë se Protokoll i është bërë pjesë e acquis dhe ratifikimi i tij është një nga detyrat e lëna për Shqipërinë në Progres Raportin e vitit 2022.	Jo	Jo	Jo	Po
11	Për ratifikimin e Konventës së Hagës për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Miratimi i këtij projektligji diktohet nga ndjekja e procedurës së parashikuar nga ligji nr.43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, me qëllim shprehjen e pëlqimit që Republika e Shqipërisë të jetë palë e Konventës së Hagës për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës	Konventa ka për qëllim sigurimin e efektivitetit të zbatimit të marrëveshjes së përzgjedhjes së gjykatës (e njohur ndryshe si "forumi i klauzolës efektive" ose "klauzola e juridiksionit", ndërmjet palëve të transaksioneve tregtare ndërkombëtare. Nevoja për të ratifikuar këtë Konventë lidhet me domosdoshmërinë e miratimit të masave për zhvillimin e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe tregtare, me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së Shteteve Anëtare në fushën e përmirësimit dhe zhvillimit të klimës së biznesit, marrëdhënieve tregtare, si dhe nxitjes së investimeve direkte të huaja. Objektivat kryesore lidhur me ratifikimin e kësaj Konvente lidhen me nxitjen e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, përmirësimin e klimës së biznesit, marrëdhënitë tregtare dhe nxitjen e investimeve direkte të huaja, si dhe ofrimin e sigurisë dhe parashikueshmërisë ligjore. Palë e Konventës është edhe Bashkimi Evropian, duke e bërë atë pjesë të acquis, ndaj vlerësojmë ratifikimin e saj një hap në drejtim të procesit të integritimit drejt BE-së.	Jo	Jo	Jo	Po



12	Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të mjekësisë ligjore në Republikën e Shqipërisë	Projektligj	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Kjo nismë ndërmerret në kuadër të reformimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Republikën e Shqipërisë si institucioni i vetëm përgjegjës për kryerjen e ekspertimeve mjeko-ligjore. Për shkak të vështirësive praktike dhe faktit se ky shërbim ofrohet bazuar në një vendim të Këshillit të Ministrave, është diktuar nevoja për hartimin për here të parë të një ligji që rregullon këtë fushë duke ofruar zbatim më të gjerë dhe rregullim më të detajuar në kuadër të përmirësimit të ofrimit të shërbimit në mbështetjen e institucioneve të drejtësisë.	Përcaktimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të shërbimit të mjekësisë ligjore, mënyra e oragnizimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, emërimi, lirimi dhe shkarkimi i ekspertëve, rregullimi i maardhënieve të punës, trajtimi financiar, të drejtat e detyrimit e tjera, rregullat mbi kryerjen e ekspertimeve dhe bashkëpunimin me institucionet e treta, administrimin e morgjeve si dhe rregullat e sjelljes dhe masat disiplinore.	JO	Jo	Jo	Po
13	Per percaktimin e kushteve per punonjësit në Policinë e Burgjeve qe mbajnë armën në përdorim personal	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Miratimi i këtij projektvendimi vjen në kuadër të ndryshimeve të bëra në ligjin nr. 80/2020 "Per policine e Burgjeve" nëpërmjet ligjit nr. 39/2023 me qëllim përcaktimin e kushteve për mbajtjen e armës nga Policia e Burgjeve	Prcaktimi i kushteve për mbajtjen e armës nga Policia e Burgjeve	Jo	Jo	Jo	Po
14	Per percaktimin e kriterëve dhe procedurës për përfitim e kredisë me kushte lehtësuese dhe masa e saj	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Miratimi i këtij projektvendimi vjen në kuadër të ndryshimeve të bëra në ligjin nr. 80/2020 "Per policine e Burgjeve" nëpërmjet ligjit nr. 39/2023 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurës për përfitim e kredisë me kushte lehtësuese	Përcaktimi i kriterëve dhe procedurës për përfitim e kredisë me kushte lehtësuese	Jo	Jo	Jo	Po
15	Per miratimin e rregullave për ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi me gradat e Policisë së Burgjeve	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Miratimi i këtij projektvendimi vjen në kuadër të ndryshimeve të bëra në ligjin nr. 80/2020 "Per policine e Burgjeve" nëpërmjet ligjit nr. 39/2023 me qllim ekuivalentimin e gradave të punonjësve në detyra të ngjashme me Policinë e Burgjeve	Përcaktimi i rregullave për ekuivalentimin e gradave të punonjësve në detyra të ngjashme me Policinë e Burgjeve dhe konkretisht punonjësit e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	Jo	Jo	Jo	Po
16	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe të planit të saj të veprimit	Projektvendim	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori III	Hartimi i një strategjie të re sektoriale të drejtësisë e cila është në përputhje me udhërrëfyesin për shtetin e së drejtës dhe vizionin e Republikës së Shqipërisë për integrimin evropian në fushën e drejtësisë	Projektvendimi synon adresimin e politikave të sistemit të drejtësisë të bazuara sipas masave strategjike të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës – Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", si dhe do të adresojë politika që lidhen me Edukimin Ligjor të Publikut në fushën e drejtësisë.	Jo	Jo	Po/Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës – Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore	Po



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2024

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për disa shtesa në Vendimin nr.1128, datë 30.12.2020 e Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin të Ministrave, "Për zbatimin të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara"	Projektvendim	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katër mujori I	Përmbushjen e detyrimeve sipas parashikimeve të ligjit nr.72/2019 "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".	Përditësimin e listës së sanksioneve të shpallura nga Këshilli i Bashkimit Evropian	Po, Kapitulli 31	Po, fusha Integrimi Evropian	Jo	Jo
2	Për shtesa/ndryshime në Vendimin nr. 420, datë 8.6. 2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e ceremonialit të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar	Projektvendim	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katër mujori I	Reflektimin në të i ndryshimeve të ligjit nr.7651, datë 21.12.1992 "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", i ndryshuar".	Ndryshimet në VKM 420/2016 synojnë reflektimin e ndryshimeve të ligjit nr. 7651/1992, i ndryshuar, lidhur me shtimin e datës 22 nëntor si festë zyrtare.	Jo	Jo	Jo	Jo
3	Për disa ndryshime në Vendimin nr.718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave "Mbi listën e personave të shpallur financues të terrorizmit, të ndryshuar	Projektvendim	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katër mujori II	Përmbushjen e detyrimeve ligjore, ligji nr. 157/2013 "Për ndalimin e financimit të terrorizmit", i ndryshuar, në varësi të shpalljeve nga KS i OKB.	Projektvendimi konsiston në përditësimin e listës së sanksioneve të shpallura nga Komiteti i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.	Jo	Po, fusha Integrimi Evropian	Jo	Jo
4	Për zonën ekonomike ekskluzive	Projektligj	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katër mujori III	Shpallja e ZEE është në përputhje me KDD (UNCLOS) dhe do të mundësojë që Shqipëria të ushtrojë të drejtat sovraane në ZEE e saj. Pra, Shqipëria do të ketë mundësi shfrytëzimi, kërkimi dhe eksplorimi në ZEE. Akti parashikohet të paraqitet si bashkëpropozim me MBRZH dhe MM.	Mundësin e ushtrimit nga Shqipëria të të drejtave sovraane për shfrytëzimin, kërkimin dhe eksplorimin e ZEE, si dhe mbrojtjen e mjedisit detar në ZEE-në e Shqipërisë.	Jo	Shpallja e ligjit sjell harmonizimin e legjisllacionit me acquis, specifikisht me Direktivën nr. 89/2014 "Për krijimin e kornizës për planifikimin hapësinor detar, si dhe në kuadër të procesit screening për Kapitullin 13.	Jo	Ndikime pozitive mjedisore, si dhe mund të ketë ndikim ekonomik për rritjen e kapaciteteve për monitorimin e ZEE.
5	Për miratimin e kuadrit rregullator për bashkëpunimin ndërkombëtar, për zhvillim dhe ndihmë humanitare	Projektvendim	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katër mujori III	Në zbatim të urdhrit të KM për hartimin e kuadrit rregullator, për bashkëpunimin ndërkombëtar, për zhvillim dhe ndihmë humanitare, me qëllim adresimin e një nga rekomandimeve kryesore të Komisionit Evropian për Shqipërinë	Hartimin e një kuadri rregullator për bashkëpunimin ndërkombëtar, për zhvillim dhe ndihmë humanitare, në kuadër të Kapitullit 30 "Marrëdhëniet me jashtë" duke ndikuar pozitivisht në procesin e	Po, Kapitulli 30	Po, fusha Integrimi Evropian	Jo	Jo



					për krijimin e një kornize ligjore për këtë, në përputhje me politikat dhe parimet e BE-së. Akti parashikohet të barazohet si bashkëpropozim me MM, MFE dhe KM.	nisur të negociatave mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.				
6	Për shtesa/ndryshime në ligjin nr. 23 datë 19.3.2015 "Për Shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë"	Projektligj	Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme	Katërmujori III	Ndryshimet në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe problematikat e hasura ndër vite nga zbatimimi në praktikë i ligjit nr. 23/2015.	Projektligji për ndrysimin e Ligjit nr. 23/2015 "Për Shërbimin e Jashtëm, synon të sjell disa risi dhe efekte pozitive që synojnë konsolidimin e mëtejshëm të këtij shërbimi mbështetur në karrierën diplomatike.	Jo	Jo	Jo	Jo



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2024

Ministri Financave dhe Ekonomisë

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për krijimin e Regjistrimit për Kthimin e Garancive Shtetërore"	Projektvendim	Ministri Financave dhe Ekonomisë	Katër mujori I	Nevoja për krijimin e regjistrimit elektronik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave, kjo si pasojë e miratimit të ligjit të ri, Ligjit 55/2023 "Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive Shtetërore të Pakthyera" Qëllimi i këtij projekt-akti rregullon procedurat si: Agjencia raporton te Regjistri i Kredive dhe zbaton kriteret e klasifikimit për bankat dhe Institucionet financiare jo-banka, në mënyrë që këto hua/kredi/detyrime të figurojnë në Regjistrin e Kredive edhe pasi t'i transferohen Agjencisë me qëllim që informacioni në Regjistrin e Kredive për këta huamarrës të jetë i plotë. Për marrëveshjet e huas të nënshkruara nga institucionet financiare pjesë e skemave të garancive përkatëse, Agjencia ka detyrë të rakordojë çdo tre muaj të dhënat me huadhënësit dhe Ministrinë përgjegjëse për financat dhe të raportojë çdo tre muaj në Ministrinë përgjegjëse për financat mbi ecurinë e skemave të garancisë. Për skemat e vecanta të garancisë, Agjencia ka detyrë të monitorojë shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj Ministrisë përgjegjëse për financat për pagesat e kryera nga kjo e fundit në kuadër të marrëveshjeve të garancisë me anë të kontrollit të dokumentacionit dhe me anë të verifikimeve të faturave dhe mandat pagesave të subjekteve.	Krijimi i një regjistrimit elektronik që do përdoret për të administruar të dhënat e subjekteve që kanë lidhur marrëveshje me Agjencinë për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera	Jo	N/A	N/A	N/A



2	"Për kuadrin makroekonomik fiskal 2024-2026"	Projektvendim	Ministri Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori I	Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2024 – 2026, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".	Kuadri Makroekonomik e Fiskal ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. KMF përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF shërben si bazë për përcaktimin e taveve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në nivel ministrie.	Jo	N/A	N/A	N/A
3	Për miratimin e Programit të reformave Ekonomike (ERP) 2024-2026	Projektvendim	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori I	Qëllimi është miratimi i dokumentit të Programit të Reformave Ekonomike për periudhën 2024-2026	Projektakti miraton dokumentin e ERP 2024-2026 që përfshin kuadrin makroekonomik dhe fiskal, listën e reformave strukturore parësore të vendit, zbatimin e përfundimeve të përbashkëta nga dialogu ekonomik dhe financiar me BE	Po	N/A	N/a	N/a
4	"Për përcaktimin e procedurave të detajuara për kthimin e garancive, huave dhe nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit e shitjes së këtyre pasurive të marra "	Projektvendim	Ministri Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori I	Nevoja për përcaktimin e procedurave të detajuara për kthimin e garancive, huave dhe nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo të Agjencisë për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera", kjo si pasojë e miratimit të ligjit të ri, Ligjit 55/2023 "Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive Shtetërore të Pakthyera"	Përcaktimi i qartë i procedurave të detajuara për kthimin e garancive, huave dhe nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo të Agjencisë për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera	Jo	N/A	N/A	N/A
5	"Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030"	Projektvendim	Ministri Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori I	Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike (SSMFP), 2019-2022, si dhe plani i veprimit 2020-2022, ka përfunduar në dhjetor 2022. Për të rritur efektivitetin e shpenzimeve buxhetore dhe për të krijuar një mjedis më produktiv për shpenzime në afat të mesëm dhe afatgjatë, vazhdimi i reformave të MFP-së është thelbësor. Për këtë qëllim, do	Strategjia e MFP-së 2023 - 2030 do të shërbejë si një kuadër që do të udhëheqë zbatimin e të gjitha reformave të qeverisë për MFP-në. SSMFP 2023-2030 do të përcaktojë drejtimit dhe prioritetet për të garantuar një sistem financash publike që promovon transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e	Jo	Po. Strategjia e MFP-së lidhet me Dokumentin e Programit të Qeverisë, specifikisht me shtyllën "Mirëqenie për të gjithë", që do të përkthehet në një ekonomi të zhvilluar që krijon shanse për të gjithë. Ky prioritet përfshin mbështetje dhe angazhim për të siguruar rritje e zhvillim ekonomik për më shumë të ardhura, një jetë	Strategjia Sektoriale për Menaxhimin e Financave Publike lidhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030. Shtylla: Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër. Qëllimi i Politikës: Në	Ndikime ekonomike - po



					të hartohet dhe miratohet strategjia e tretë për menaxhimin e financave publike, që do të mbulojë periudhën 2023 – 2030.	burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik.		dinjitoze e përfshirje në jetën ekonomike për të gjithë qytetarët, duke vënë theksin tek bizneset e vogla, tek familjet produktive, fshati dhe forca punëtore që shtyn përpara zhvillimet pozitive të vendit. Për këtë arsye, Qeveria Shqiptare është e angazhuar fort në drejtim të përmbushjes së objektivave (shënjestrave të mandatit qeverisës 2021-2025) për të siguruar një rritje ekonomike mesatarisht 4.5 % në vit dhe do të mbështesë një rritje edhe më të madhe të pagave në nivel vendi; Konsolidim të përshpejtuar fiskal duke synuar borxh nën 60% në fund të mandatit dhe rritje të ardhurave të disponueshme me 20% deri në fund të mandatit.	seksionin "Fuqizimi i financave publike dhe stabiliteti fiskal" të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Europian, parashikohen çështjet kryesore që lidhen drejtpërdrejtë me financat publike: (1) Menaxhimin financiar i matur, efektiv dhe efikas i qeverisjes vendore; (2) Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike; (3) Forcimi dhe zbatimi i sistemit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik në qeverisjen qendrore dhe vendore.	
6	"Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore"	Projektvendim	Ministri Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori I	Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe të Ligjit Vjetor të Buxhetit	Shpërndarja e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2024	Jo	N/A	N/A	N/A
7	"Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të qendrave të formimit profesional"	Projektvendim	Ministri Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori I	Eshtë duke u ndertuar baza e të dhënave e të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të Qendrave të formimit profesional) e cila kërkon miratim nga Këshilli i Ministrave	Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të qendrave të formimit profesional	Jo	N/A	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030	Ky projektakt prodhon ndikim financiar për buxhetin e shtetit.
8	"Për miratimin e Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2023 - 2030 dhe Planit të Veprimit"	Projektvendim	Ministri Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori I	Zhvillimi i politikave në fushën e marrëdhënieve të punës, inspektimit, sigurisë dhe shëndetit në punë, është një ndër përgjegjësitë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kjo përgjegjësi, ka lindur nevoja për zhvillimin e politikave të "Sigurisë dhe Shëndetit në Punë", konkretisht është domosdoshmëri hartimi i një "Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", të ri, për të ardhmen.	Në kuadër të Kapitullit 19 "Politikat Sociale dhe të Punësimit", si dhe të rekomandimeve në vijim të takimit të Nënkomitetit për "Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikat Sociale", del i nevojshëm hartimi i këtij dokumenti. Ky është hapi i parë i nevojshëm, që duhet të ndërmerret për organizimin e gjithë faktorëve që kanë ndikim dhe interesa në fushën e marrëdhënieve të punës, me qëllim nisjen e hartimit e të një "Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", për vitet e ardhshme.	Jo	Po	Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, nuk është përfshirë hartimi i një strategjie për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, por ajo konsiderohet si dokument plotësues strategjik i "Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si dhe të Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023 - 2024", ndaj dhe forma e hartimit të këtij dokumenti do të jetë "Dokument Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë,	Po



									2023 - 2030 dhe Planit të Veprimit".	
9	"Për miratimin e kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike 2024"	Projektvendim	Ministri Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori I	Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar	Paraqet një kalendar me aktivitetet dhe datat perkatëse për një miremenaxhim të financave publike	Jo	N/A	N/A	N/A
16	Për miratimin e Rregullores "Nivelet e lejuara të radiobërthamave në ujin për konsum njerëzor, për mbrojtjen e publikut".	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori III	Në mbështetje të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar.	Projektvendimi rregullon përqëndrimin e radiobërthamave për konsum njerëzor. Ky projektvendim përfshin ujin për konsum mjekësor, qoftë në gjendjen e tij origjinale ose pas trajtimit, i cili është i destinuar për të pirë, gatim, përgatitje ushqimi apo qëllime të tjera shtëpiake, pavarësisht se nga vjen dhe nëse furnizohet nëpërmjet një rrjeti, cisternë, shishe apo kontejnerë. Projektvendimi nuk zbatohet për ujërat minerale natyrale ose për ujin që konsiderohet si produkt medicinal. Në përmbajtje të projektvendimit përcaktohen vlerat dhe parametrat, frekuencat dhe mënyrën për monitorimin e radiobërthamave. Projektvendimi parashikon dhe rastet kur identifikohet një rrezik i mundshëm për shëndetin.	Projektvendimi është parashikuar në PKIE 2024, synon përafrim të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian, direktivën 2013/51 Euroatom. Kapitulli 15 Energjia	Jo	Strategjisë Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 e miratuar me Vendimin nr. 210, datë 6.4.2022 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030".	Ndikime financiare - Po Ndikime mjedisore - Jo Ndikime sociale -Po
----	---	---------------	---	-----------------	---	---	--	----	---	--



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2024

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10463, date 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve	Ndryshimi i masës së gjobave dhe subjekteve që ngarkohen për zbatimin e masës, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve	Jo	PO Menaxhim i integruar i mbetjeve në tërësinë e territorit sipas Masterplanit	VKM nr. 418,, date 27.5.2020 "Per miratimin e Dokumentit te Politikave Strategjike dhe te Planit Kombetar per menaxhimin e integruar te mbetjeve"	Rritja e të ardhurave nga gjobat, përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, përmirësimi i cilësisë së jetesës
2	Për një ndryshim në ligjin nr.162/2014 "Për cilësinë e ajrit në mjedis", i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Të përmirësojë shëndetin publik dhe të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit;	Ndryshimi i masës së gjobave kundrejt subjekteve (operatorët e instalimeve, nga aktivitete apo përdorimi i lëndëve djegëse jo në përputhje me kriteret ligjore) në mosrespektim të kërkesave, parimeve dhe kushteve të shkarkimeve në ajër; Rishikimi i insitucioneve përgjegjëse për kontrollin e zbatueshmërisë të kërkesave ligjore, në përputhje me fushën e përgjegjësisë dhe aktet nënligjore që kanë dalë zbatim të këtij Ligji (institucione varësie të MTM, MIE apo të tjera);	Jo	N/A	VENDIM Nr. 594, datë 10.9.2014 PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR CILËSINË E AJRIT TË MJEDISIT	Rritja e të ardhurave nga masat administrative, përmirësimi i cilësisë së ajrit, përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mjedisit;
3	Për një ndryshim në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Adresimi i konkluzioneve të Keshillimit Kombetar	Ndyshimet do të konsistojnë në ashpërsimin e kundrvajtve administrative	Jo	Jo	N/A	Projektakti do të ketë ndikim social, mjedisor dhe ekonomik.
4	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10448 "Për lejet e mjedisit".	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Përmirësimi i proceseve dhe procedurave të konstatuara gjatë zbatimit të ligjit aktual	Ndyshimet do të konsistojnë në zgjidhjen e problematikave të hasura me lejet dhe ashpërsimin e kundrvajtve administrative	Jo	Jo	N/A	Projektakti do të ketë ndikim social dhe mjedisor.
5	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10440/2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" i ndryshuar	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Adresimi i konkluzioneve të Keshillimit Kombetar	Ndyshimet do të konsistojnë në ashpërsimin e kundrvajtve administrative	Jo	Jo	N/A	Projektakti do të ketë ndikim social dhe mjedisor.
6	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587/2006 "Për mbrojtjen e Biodiversitetit" i ndryshuar.	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Ashpërsimi i kundrvajtve administrative në funksion të parandalimit të shkeljeve në florë dhe faunë	Parashikimi në legjisllacionin e mbrojtjes së biodiversitetit të dënimit me gjobë si titull ekzekutiv do të sjellë efektivitet në ekzekutimin e sanksioneve që vendosen nga organet administrative,duke sjelle: • Zvogëlimin dhe parandalimin e dëmtimit të biodiversitetit ndaj ndotjes së mjedisit • Mbrojtja dhe ruajtja e diversitetit biologjik; • Minimizimi i ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve gjenetike; • Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe	Jo	Po	SKZHI	Projektakti do të ketë ndikim social dhe mjedisor.



						<p>bizneseve per moskryerjen e veprimeve në dem të mjedisit nëpërmjet organizimit të fushatave sensibilizuese;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Garantimi i respektimit te legjislacionit ne fuqi për mbrojtjen e mjedisit. rritja e efikasitetit të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e rregullave të aplikueshme për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet riorganizimit të proceseve inspektuese. 				
7	"Për disa ndryshime në VKM nr. 641/2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte", të ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Kalimi online i shërbimit përmes sistemit e-Albania dhe lehtësimin e subjekteve për autorizimin e eksportit të mbetjeve dhe kalimin transit.	Kalim on-line i procesit të aplikimit nga personat fizikë e juridikë dhe shqyrtimi e miratimi i autorizimit për eskport mbetjesh dhe tranzit mbetjesh jo të rrezikshme plotësisht on-line	Jo	Jo	Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035	Përshpejton dhe lehtëson subjektet për pajisjen me Autorizimin e kalimit tranzit dhe eksportin e mbetjeve.
8	"Për miratimin e rregullave të detajuara për regjistrimin e kimikateve nga prodhuesit dhe importuesit, detyrimet për të raportuar në regjistrin elektronik të kimikateve, si dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kimikateve"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Ky projektvendim del ne zbatim te pikës 4, neni 27 "Rregjistri i Kimikateve", të Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve".	Ngritja dhe funksionimi për herë të parë i regjistrit kombëtar të kimikateve, nje databazë me të dhëna mbi subjektet të cilat operojnë në treg duke përfshire regjistrimin e kimikateve.	Jo	N/a	Projektvendimi është në një linjë me Strategjinë Ndërsëktoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut 2023-2030, si dhe me Planin Kombëtar për menaxhimin e sigurtë të kimikateve.	Projektvendimi do të ketë ndikim ekonomik dhe mjedisor.
9	"Për përcaktimin e skemave te certifikimit dhe kërkesave për procesin e certifikimit të personit	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Detyrat si mëposhtë duhet të certifikohen nga një organ i akredituar për certifikim personi: a)Instalim, servis, mirëmbajtje, riparim ose cmontim të pajisjeve të listuara, në pikat "a" deri në "dh", të nenit 5; b) kontrolltet e rrjedhjeve të pajisjeve të përmendura në pikat "a" deri në "d", të nenit 5; c) rikuperimin e gazeve serrë të flouorinuara, sic parashikohet në nenin 8.	Përcaktimi i skemave të certifikimit të personave që meren me gazet serrë të fluorura	Po/ Kapitulli 27	N/a	Jo	Projektvendimi do të ketë ndikim ekonomik dhe mjedisor.
10	Për zbatimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit	Projektligj	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Ky projektligji do të përgatitet në kuadër të rregullimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në vend	Për shkak se ende nuk është plotësuar sistemi për menaxhimin e integruar të mbetjeve (jo çdo qark ka landfill sanitar funksional, stacione transferimi, kosha të mjaftueshëm për të pasur të veçanta rrymat e mbetjeve) e cila ndikon drejtpërdrejt në mungesën e ndarjes së mbetjeve në burim por duke konsideruar edhe mjetet financiare të pamjaftueshme/të limituara, një zgjidhje për të bërë sistemin të funksionojë, është ngritja e një skeme të qëndrueshme për Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit, e cila mundëson ndarjen e përgjegjësive me prodhuesit. Këta të fundit sjellin produkte në tregun shqiptar (prodhim, importim), produkte të cilat pas përdorimit gjenerojnë mbetje. Skema e Përgjegjësive së Zgjeruar të Prodhuesit,	Po kapitulli 27	Po. Projektligji është në përputhje me programin politik, dhe specifikisht me menaxhimin e integruar të mbetjeve në tërësinë e territorit.	Po, lidhet me Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Mbetjeve".	Ky projektakt pritet të krijojë kushte pozitive për zhvillimin e disa aktiviteteve ekonomike, që sigurojnë punësim, të ardhura për buxhetin dhe ekonominë lokale. Për shkak të modelit të zhvillimit, supozohet të mos ketë impakt negativ mjedisor, më pak mbetje të depozituara në kosha dhe pikat fundore dhe një



						mundëson ngritjen e sistemit për çdo prodhues me qëllim mbledhjen e diferencuar të mbetjeve, riciklimin dhe trajtimin e tyre sipas rymave që ato i përkasin dhe në përputhje me objektivat e vendosura nga qeveria. Kjo skemë është një instrument balancues për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve të rymave specifike, i cili vendos kundrejt prodhuesit përgjegjësi financiare për mbledhjen, riciklimin dhe përgjegjësinë e mbetjeve në fund të jetës.				ritje të zhvillimit të turizmit për shkak të mjedisit më të pastër.
11	"Për miratimin e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen e sipërmarrësit me licencën III.3"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Projektligji "Për gazet serrë të Fluoruarë" parashikon pajisjen me licence për sipërmarrësit që kryejnë importin, eksportin, magazinimin dhe vendosjen në treg të gazeve serrë të fluoruara, të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara, ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze, në përputhje me kriteret, kushtet, afatet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë dhe përfshihen në kategorinë III. 3, të aneksit të tij.	Dokumentacioni i nevojshëm për pajisjen e sipërmarrësit me licencën, sipas pikës 1, të këtij neni, miratohet nga Keshilli I Ministrave me propozim nga ministri përgjegjës për mjedisin.	Jo	N/a	Strategjia për ndryshimet klimatike dhe Dokumenti I Kontributit Kombëtar të Përcaktuar 2021-2030	Futja e licences pritet të ketë impakt pozitiv në rregullimin e tregut
12	"Për miratimin e ndarjes së kuotave vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të para-mbushura me hidrofluorokarbone, si dhe kriteret për ndarjen e kuotave"	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Ky akt ka për qëllim vendosjen e mënyrës së ndarjes së kuotave të importit të hidrofluorokarboneve dhe kriteret për ndarjen e kuotave si dhe kushtet, dokumentacioni shoqërues, procedura, afate për dhënie e autorizimit për kuotën , në zbatim të pikës 2 dhe 3 të Nenit 20 të Ligj Nr.2/2023 "Për gazet serrë të Fluoruarë"	Ligji Nr.2/2023 ka për qëllim reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluoruara, në mënyrë që të arrihet mbrojtja e mjedisit nepermjet vendosjes se kujtjve sasiorë për hedhjen në treg të hidrofluorokarboneve;	Jo	N/a	JO	Projektvendimi do të ketë ndikim ekonomik dhe mjedisor.
13	Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura"	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Përmirësim dhe plotësim i aktit	Plotësimi i kuadrit ligjor dhe përmirësimi i tij në funksion të identifikimit të problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të ligjit nr.81/2017	Jo	Po	SKZHI	Po
14	Për një ndryshim në VKM nr. 371/2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", të ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Shkurtimi i afatit për pajisje me Kod Unik për mbetjet e rrezikshme	Rishikim i procedurës në funksion të shkurtimit të afatit të trajtimit , në kuadër të procesit të derregullimit	Jo	Jo	Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035	Shkurtohen afatet e pajisjes me Kodin Unik
15	Për një ndryshim në VKM Nr. 229, datë 23.04.2014, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", i ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Shkurtim i afatit për pajisjen me Kod Unik për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme	Rishikim i procedurës në funksion të shkurtimit të afatit të trajtimit , në kuadër të procesit të derregullimit	Jo	Jo	Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035	Shkurtohen afatet e pajisjes me Kodin Unik
16	"Për disa ndryshime në VKM nr. 285, datë 29.4.2022 "Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Rishikimi i Vendimit në kuadër të procesit të riinxhinierimit dhe derregullimit	Ofrimi i shërbimit online, rishikimi i dokumentacionit në funksion të heqjes dhe rishikimi i afateve të trajtimit të kërkesës	Jo	Jo	Ky projektakt është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të	Po



	të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit"								Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, me Objektivin Politik 1: Nxitje e Investimeve Publike dhe Private, me aktivitetin "Kuatër ligjor miqësor me biznesin për të përshpejtuar zhvillimin e sektorit" dhe Objektivin Politik 2: Përmirësimi i Shërbimeve Turistike dhe objektivin specifik 2.3 Hartimi i kuadrit rregullator dhe institucional për zhvillimin e shërbimeve dhe mënyrën e operimit të Porteve Turistike dhe aktiviteteve në funksion të tyre	
17	"Për miratimin e rregullave të detajuara për organizimin dhe funksionimin e regjistrit, produktet dhe pajisjet përkatëse që regjistrohen, detyrimet e sipërmarrësve për të raportuar, si dhe niveli i aksesueshmërisë së regjistrit "	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Ky projektvendim del ne zbatim te pikës 4, neni 16 të ligjit nr.2/2023 "Për gazet serrë të fluoruar", dhe plotëson kuadrin nënligjor në këtë fushë	Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.2/2023 "Për gazet serrë të fluoruar", Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon një bazë të dhënash në regjistrin elektronik për gazet serrë të fluoruara në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore. 2. Regjistrimi në këtë regjistër është i detyrueshëm për: a) prodhuesit dhe importuesit, të cilëve u është alokuar një kuotë e përcaktuar për vendosjen në treg të hidrofluorokarboneve; b) sipërmarrësit, të cilëve u është transferuar kuota e hidrofluorokarboneve; c) prodhuesit dhe importuesit që furnizojnë ose sipërmarrës që furnizohen me hidrofluorokarbone sipas pikave 3 dhe 4 të nenit 14 të këtij ligji; ç) importuesit e pajisjeve të parambushura kur hidrofluorokarbonet e përmbajtura në pajisje nuk janë vendosur në treg para mbushjes së pajisjes sipas nenit 14 të këtij ligji; d) informimin e prodhuesve dhe importuesve për kuotat e alokuara dhe për çdo ndryshim në këto kuota.	Jo	N/a	Projektvendimi është në një linjë me Kontributin Kombëtar të Përcaktuar, i rishikuar, drejtuar Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike.	Projektvendimi do të ketë ndikim ekonomik dhe mjedisor.
18	"Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.692 datë 05.10.2016 "Për miratimin e	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Rishikimi i vendimit në kuadër të përfaqjes me Kodin e Procedurës Administrative përsa i përket mosplotësim të dokumentacionit	Lehtësim procedurash duke e përshtatur me KPrAdm dhe shkurtim afati të shqyrtimit të aplikimit, si dhe heqja e afatit të certifikatës dhe rinovimi i saj	Jo	Jo	Ky projektakt është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të	Po



	regullore "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre", i ndryshuar				dhe rishikim i afateve të trajtimit të kërkesës si dhe ndryshimet për shkak të ndryshimeve ligjore			Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, me Objektivin Politik 2: Përmirësimi i Shërbimeve Turistike dhe objektivin specifik 2.2 Krijimi i Kuadrit Rregullator dhe Institucional për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimi i burimeve njerëzore të angazhuara në sektor		
19	"Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2024-2030 dhe Planit të Veprimit	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori III	Me përfundimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 lind nevoja për hartimin e një dokumenti të ri strategjik me qëllim përcaktimin e politikave dhe objektivave që synohen të arrihen për periudhën 2024-2030. është përcaktuar ky afat duke qenë në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030.	Ky dokument do të përcaktojë vizionin për zhvillimin e turizmit deri në vitin 2030 si dhe objektivat strategjike. Dokumenti do të orientojë politikën e turizmit me qëllim shndërrimin e turizmit në një instrument për zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të të gjithë territorit, duke e vendosur Shqipërinë në tregun turistik rajonal si një nga ofruesit më konkurrues, inovativ dhe autentik të turizmit. Objektivat strategjike do të jenë: 1. Nxitja e investimeve; 2. Rritja e standardeve dhe cilësisë së shërbimeve; 3. Përmirësimi i burimeve njerëzore, njohurive dhe aftësive në turizëm; 4. Zhvillimi i zgjidhjeve dixhitale, inovative dhe teknologjive të reja në turizëm; 5. Zhvillimi i një turizmi përgjatë gjithë vitit dhe në të gjithë vendin; 6. Promovimi i Shqipërisë si një destinacion original dhe i ofertave turistike unike.	Jo	Ky projektakt është në përputhje me programin politik 2021-2025, me kapitullin "Turizmi dhe Mjedisit".	Ky projektakt është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030, me kapitullin "Zhvillimi i turizmit".	Projektakti do të ketë ndikim ekonomik, financiar, social dhe mjedisor.



VENDIM

Nr. 795, datë 28.12.2023

**PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE
TË QEVERISJES QENDRORE NË
PROCESIN E SHQYRTIMIT ANALITIK
TË ACQUIS (SCREENING), NË KUADËR
TË PROCESIT TË NEGOCIATAVE ME
BASHKIMIN EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin për paraqitje të mirë të Republikës së Shqipërisë në procesin e shqyrtimit analitik të *acquis (screening)*, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, zhvilluar midis datave 15 shtator 2022 deri më 24 nëntor 2023, të punonjësve organikë të njëjësive të qeverisjes qendrore, të cilët janë aktualisht në marrëdhënie pune në njësitë e qeverisjes qendrore, si më poshtë vijon:

a) Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator dhe negociatorët, të përcaktuar sipas vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar, që kanë qenë në këtë pozicion përgjatë periudhës së parashikuar në këtë vendim;

b) Pjesëmarrësit e delegacionit të Republikës së Shqipërisë, si më poshtë vijon:

i. Personat të cilët kanë marrë pjesë (fizikisht) në takimet dypalëshe për shqyrtimin analitik të *acquis (Screening)*, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, në Bruksel;

ii. Prezantuesit *online* dhe mbështetësit *online*, sipas agjendave zyrtare dërguar shërbimeve të Komisionit Evropian të takimeve dypalëshe për shqyrtimin analitik të *acquis (Screening)*, në kuadër

të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian;

c) Kontribuesit në përgatitjen përmbajtjesore të takimeve dypalëshe për shqyrtimin analitik të *acquis (Screening)* për negociatat me Bashkimin Evropian, sipas kontributit në përgatitjet dhe paraqitjen e mirë, të përcaktuar nga çdo negociator për kapitull dhe/ose kriter, si më poshtë vijon:

i. Në masën deri në 10 punonjës kontribues për kapitull, për kapitujt 1, 11, 12, 14, 27;

ii. Në masën deri në 5 punonjës kontribues për kapitull, për kapitujt dhe kriteret e tjera;

ç) Sekretariatet e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE), sipas urdhrit nr. 94, datë 20.5.2019, të Kryeministrit, si dhe sekretariati i përcaktuar, sipas pikës 3, të kreut V.1, të urdhrit nr. 57, datë 24.4.2023, të Kryeministrit;

d) Punonjësit e Departamentit të Politikës dhe Integritimit Evropian, në Kryeministri, si edhe të kabinetit të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator;

dh) Ambasadori dhe personeli diplomatik i Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian, në Bruksel.

2. Masa e shpërblimit të jetë një pagë mujore bruto, sipas pagës që nëpunësit përfitues, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kanë në momentin e hyrjes në fuqi të tij, por jo më shumë se paga e funksionit ministër Shteti dhe Kryenegociator, dhe për një shpërblim të vetëm.

3. Negociatori në detyrë, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, konfirmon pranë institucioneve përkatëse, për çdo kapitull dhe/ose kriter, listën e punonjësve që përfitojnë shpërblimin, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1 të këtij vendimi.

4. Punonjësit sipas pikës 1, të këtij vendimi, të cilët kanë ndryshuar pozicionin e punës, por që janë ende në marrëdhënie pune në njësitë e qeverisjes qendrore, përfitojnë shpërblimin nga institucioni përkatës ku kanë kontribuar për takimet dypalëshe, bazuar në konfirmimin nga negociatori përkatës për kapitullin dhe kriterin përkatës.

5. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga fondi i veçantë, sipas nenit 12, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar me aktin normativ nr. 6, datë



14.12.2023, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022, ‘Për buxhetin e vitit 2023’”. Njësitë e qeverisjes qendrore paraqesin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën për fonde shtesë, me qëllim ekzekutimin e këtij vendimi. Ministria e Financave dhe Ekonomisë miraton dhe alokon fondin përkatës.

6. Institucionet publike jobuxhetore shpërblejnë me burimet financiare të tyre punonjësit sipas pikës 1 të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e qeverisjes qendrore të kryejnë veprimet financiare për zbatimin e këtij vendimi deri në datën 15 janar 2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 797, datë 28.12.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE DHE
TË RREGULLAVE PËR SHPËRBLIMIN
NË NATYRË TË SHPRONËSIMEVE PËR
INTERES PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rasteve dhe i rregullave për shpërblimin në natyrë të shpronësimeve për interes publik.

Neni 2

**Parime dhe rregulla të përgjithshme të
shpërblimit në natyrë**

1. Shpërblimi në natyrë i shpronësimeve për interes publik realizohet duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të të drejtave të tyre pasurore.

2. Shpërblimi në natyrë i shpronësimeve për interes publik bëhet në respektim të parimit të shpërblimit të drejtë, në përputhje me pikën 4, të nenit 41, të Kushtetutës, dhe me nenin 153 të Kodit Civil.

3. Në çdo rast, pasuria e paluajtshme në pronësi të shtetit, që mund të përdoret si shpërblim në natyrë, duhet të jetë e lirë nga çdo lloj barre, konflikti gjyqësor apo pengesë tjetër ligjore.

4. Në çdo rast, shpërblimi në natyrë realizohet vetëm pasi merret pëlqimi i subjektit që shpronësohet. Pëlqimi i subjektit që shpronësohet për të marrë shpërblimin në natyrë duhet të jetë unanim i të gjithë bashkëpronarëve, e konfirmuar nëpërmjet një akti noterial të nënshkruar nga të gjithë bashkëpronarët ose përfaqësuesit e tyre me prokurë, në të cilin përshkruhet në mënyrë të qartë e të saktë pasuria e paluajtshme në pronësi të shtetit, që do të përdoret si shpërblim në natyrë dhe pranimi i shpërblimit për shpronësimin për interes publik nëpërmjet shpërblimit në natyrë.

5. Subjekti kërkues mund të propozojë kompensimin nëpërmjet shpërblimit në natyrë për të gjithë ose për një pjesë të pronarëve, që preken nga projekti për të cilin po kryhet shpronësimi për interes publik.

6. Procedura e shqyrtimit, e miratimit dhe e ekzekutimit të shpronësimit është e njëjtë si në rastet kur pasuria që shpronësohet shpërblehet në vlerë financiare, siç përcaktohet në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe në rregullat e parashikuara në këtë vendim.

Neni 3

Rastet e shpërblimit në natyrë

1. Shpërblimi në natyrë kryhet, kur:

a) vlera e shpronësimit është shumë e lartë në raport me vlerën e fondit buxhetor të shpronësimeve; ose



b) pronarët e pronës që shpronësohet, në rastet kur është njësi banimi, nuk kanë njësi banimi tjetër në pronësi, kanë nevojë strehimi dhe atyre mund t'u sigurohet banesë nga banesat në pronësi të shtetit.

2. Subjektet që shpronësohen për interes publik, në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shpërblehen në natyrë:

a) nëpërmjet shkëmbimit të pasurisë, pronë private, që shpronësohet me një pasuri tjetër të paluajtshme, në pronësi të shtetit me të njëjtën vlerë me pasurinë që shpronësohet;

b) nëpërmjet kombinimit të formës së shpërblimit në vlerë financiare me shkëmbimin në natyrë të pasurisë, pronë private, që shpronësohet me një pasuri të paluajtshme në pronësi të shtetit, sipas rasteve të parashikuara në këtë vendim.

3. Përjashtohen për t'u ofruar për shkëmbim pasuritë e paluajtshme në pronësi të shtetit, që ndodhen në zonat bregdetare, zonat për zhvillimin e turizmit dhe pasuritë e tjera që ndalohen për t'u tjetërsuar, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për shpronësimet, që shpërblehen në natyrë

1. Kërkesa për shpronësim me shpërblimin në natyrë paraqitet nga subjekti kërkues në favor të të cilit bëhet shpronësimi, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, siç përcaktohet në nenin 10, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, si dhe:

a) relacionin shpjegues, në të cilin argumentohet mungesa e fondeve për shpronësim apo raporti i saj i lartë me vlerën e fondit buxhetor të shpronësimeve, arsyeja e përfshirjes së shpërblimit në natyrë të subjekteve që preken nga shpronësimi, si dhe pjesët takuese të subjekteve që do të shpronësohen e do të kompensohen nëpërmjet shkëmbimit me një pasuri të paluajtshme në pronësi të shtetit;

b) aktet kadastrale të pasurisë së paluajtshme në pronësi të shtetit, ku të pasqyrohen referenca të plota lidhur me zonën kadastrale, numri i pasurisë, volum faqe, sipërfaqja e pronës dhe vlera e pasurisë shtetërore, bazuar në çmimet në fuqi të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) konfirmimin me shkrim të organit kompetent për pasurinë shtetërore, e cila mund të përdoret si shkëmbim në natyrë;

ç) listën e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen, për të cilët mënyra e kompensimit parashikohet të jetë nëpërmjet shpërblimit në natyrë, sipërfaqen e këtyre pasurive dhe vlerësimin paraprak të tyre;

d) pëlqimin e subjektit që shpronësohet për të marrë shpërblimin në natyrë.

2. Shpërblimi në natyrë mund të kërkohet edhe nga vetë subjekti, pasuria pronë private e të cilit do të shpronësohet, duke paraqitur kërkesën për shpërblim në natyrë pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim.

3. Në rast se kërkesa bëhet sipas pikës 2 të këtij neni, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin ndjek procedurën deri në nënshkrimin ose jo të marrëveshjes, duke bërë paraprakisht:

a) vlerësimin, nëse subjekti, pasuria pronë private e të cilit po i shpronësohet, është në një prej rasteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 3;

b) marrjen e dakordësisë nga ministria përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore për mundësinë e kryerjes së shpërblimit në natyrë me një pasuri të paluajtshme në pronësi të shtetit.

4. Vetëm në rastin kur plotësohen të dyja kushtet paraprake të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin vijon procedurën për kryerjen e shpërblimit në natyrë me një pasuri të paluajtshme në pronësi të shtetit. Në rast se një nga kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, nuk plotësohet, kompensimi i pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, bëhet vetëm me vlerë financiare.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse

1. Gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për shpronësim, në rast se Agjencia Shtetërore për Shpronësimin vlerëson që ndodhemi në një prej rasteve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, të këtij vendimi, kërkon informacion dhe dokumentacionin përkatës nga Agjencia Shtetërore për Kadastrën dhe institucione të tjera shtetërore lidhur me pasuritë, pronë shtetërore, që propozohen të shkëmben.

2. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës për



shpronësim ose plotësimin të mangësive që mund të ketë, kërkon dakordësi me shkrim nga ministria përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore, në rastin kur pasuria që do të shkëmbehet është në pronësi të shtetit, nga ministria që ka në përgjegjësi administrimi pasurisë e paluajtshme në pronësi të shtetit ose nga njësia e vetëqeverisjes vendore, në rastin kur pasuria që do të shkëmbehet është në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Organet përkatëse duhet të shprehen brenda 10 (dhjetë) ditëve mbi kërkesën e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

3. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, pas pranimit të kushteve të ofruara, ndjek procedurën për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, dhe ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore.

4. Në rast se kërkesa për shpronësim bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe pasuria e paluajtshme që do të shkëmbehet është në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, marrëveshja lidhet nga njësia përkatëse, pas marrjes së miratimit nga këshilli bashkiak, i cili ushtron të drejtën e administrimit të pronës, sipas ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

5. Në rastet kur pasuria e paluajtshme që do të shkëmbehet është në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, por subjekt kërkuar nuk është njësi e vetëqeverisjes vendore, këshilli bashkiak përkatës merr vendim për dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të shtetit dhe përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore. Ministria përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore ndjek procedurën për revokimin e së drejtës së pronësisë nga njësi e vetëqeverisjes vendore dhe kalimin në pronësi të shtetit.

6. Në rastet kur pasuria e paluajtshme që do të shkëmbehet është në pronësi të shtetit dhe në përgjegjësi administrimi të njërit prej ministrive, pas marrjes së dakordësisë me shkrim, sipas pikës 2 të këtij neni, ndiqet procedura për kalimin në përgjegjësi administrimi, me qëllim tjetërsimin e shkëmbimit e pasurisë përkatëse të ministria përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi, të ministria përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore, vijohet me procedurën për kryerjen e shpërblimit në

natyrë deri në lidhjen e marrëveshjes ndërmjet palëve.

KREU II PROCEDURA DHE RREGULLAT PËR SHPËRBLIMIN NË NATYRË

Neni 6

Procedura për kryerjen e shpërblimit në natyrë

1. Kërkesa për shpronësimin që shpërblehet në natyrë verifikohet nga komisioni i ngritur në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar.

2. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, së bashku me kërkesën për shpronësim, i vendos në dispozicion komisionit dakordësinë me shkrim të dhënë nga institucionet e përmendura në nenin 5 të këtij vendimi, si dhe çdo dokument tjetër lidhur me pasuritë që janë objekt shkëmbimi.

3. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga ngritja e tij, komisioni shqyrton e verifikon kërkesën e paraqitur nga subjekti kërkuar dhe dokumentacionin e paraqitur për kryerjen e shpërblimit në natyrë. Në rast se kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë ose i saktë, komisioni i kërkon subjektit kërkuar plotësimin e dokumentacionit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja dëni.

4. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i paraqitjes së kërkesës ose nga momenti i plotësimit të dokumentacionit, verifikon vlerën e pasurisë që po shpronësohet e që shkëmbehet, sipas përcaktimeve në nenin 5 dhe 6 të këtij vendimi.

5. Në përfundim të verifikimeve të nevojshme dhe të procedurave të parashikuara në këtë vendim, kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruar plotësojnë kriteret e përcaktuara, komisioni vendos:

a) shkëmbimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, me një pasuri tjetër të paluajtshme, pronë shtetërore; ose

b) shkëmbimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, me një pasuri tjetër të paluajtshme, pronë shtetërore, të kombinuar me shpërblim financiar shtesë, sipas parashikimeve të këtij neni.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e vendimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin njofton subjektin kërkuar në favor të të cilit kërkohet të bëhet shpronësimi, si dhe subjektet, pasuria pronë private e të cilëve do të shpronësohet,



duke bërë njëkohësisht edhe publikimin e kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare. Kërkesa për shpronësim në Fletoren Zyrtare përmban edhe vlerësimin paraprak të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, si edhe të pasurisë së paluajtshme, pronë shtetërore, që do të shkëmbehet.

7. Pronarët privatë ose personat e tretë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit apo e publikimit, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin. Komisioni shqyrton pretendimet e kërkuarve brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e tyre.

8. Në përfundim të procesit, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin përcjell pranë ministrisë përgjegjëse për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, i cili, përveç dokumentacionit të parashikuar në nenin 20, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, përmban edhe:

a) relacionin shpjegues, në të cilin argumentohet arsyeja e përfshirjes së shpërblimit në natyrë të subjekteve që preken nga shpronësimi për interes publik, si dhe pjesët takuese të subjekteve që do të shpronësohen e kompensohen nëpërmjet shkëmbimit me një pasuri të paluajtshme në pronësi të shtetit;

b) listën përfundimtare të pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen, për të cilët mënyra e kompensimit parashikohet të jetë nëpërmjet shpërblimit në natyrë, si dhe dokumentin që vërteton pëlqimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, për shpërblimin në natyrë;

c) dokumentacionin e plotë të vlerësimit të pasurive që shkëmbehen;

ç) çdo dokument tjetër të nevojshëm që ka shoqëruar procedurën e kryerjes së shkëmbimit të pasurive.

9. Pas miratimit të vendimit të shpronësimit nga Këshilli i Ministrave, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, kryhet procedura për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, dhe ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore apo njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas rastit.

10. Mosnënshkrimi i marrëveshjes nga pronari i pasurisë pronë private pas dhënies së pëlqimit dhe miratimit të vendimit të shpronësimit nga Këshilli i

Ministrave nuk e pengon kryerjen e procedurës së shpronësimit.

11. Pasuria e paluajtshme në pronësi të shtetit regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, sipas legjislacionit në fuqi, në pronësi të pronarit privat, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga lidhja e marrëveshjes, sipas pikës 9 të këtij neni.

12. Pasuritë pronë private të shkëmbyera duhet të regjistrohen në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, sipas legjislacionit në fuqi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga lidhja e marrëveshjes, sipas pikës 9 të këtij neni, në pronësi të organit shtetëror përkatës ose të subjektit kërkuar, sipas kërkesës së këtij të fundit.

Neni 7

Rregullat e shpërblimit në natyrë sipas llojit të pasurisë

1. Si rregull, shpërblimi në natyrë realizohet me të njëjtën kategori prone që është objekt shpronësimi, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Kur pasuria që shpronësohet është shtëpi banimi dhe truall funksional i shtëpisë, pronari privat shpërblehet me sipërfaqe ndërtimi, banimi dhe/ose sipërfaqe truall në pronësi të shtetit, me vlerë që i korrespondon vlerës së kompensimit të pronës private që po shpronësohet.

b) Kur pasuria që shpronësohet është truall, pronari privat shpërblehet me sipërfaqe truall në pronësi të shtetit, me vlerë që i korrespondon vlerës së kompensimit të pronës private që po shpronësohet.

c) Kur pasuria që shpronësohet është tokë bujqësore, pronari privat shpërblehet po me tokë bujqësore në pronësi të shtetit, me vlerë që i korrespondon vlerës së kompensimit të pronës private që po shpronësohet.

ç) Kur pasuria që shpronësohet është njësi tregtimi, pronari privat shpërblehet me njësi banimi ose njësi tregtimi në pronësi të shtetit, me vlerë që i korrespondon vlerës së kompensimit të pronës private që po shpronësohet.

2. Në rastet kur shpërblimi në natyrë nuk mund të bëhet sipas rasteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për shkak të kufizimeve që mund të kenë pasuritë ose pamundësive objektive, shpërblimi në natyrë mund të bëhet edhe me kategori prone të ndryshme. Për dy pasuritë që do të shkëmbehen, edhe pse mund të jenë kategori të ndryshme, për përllogaritjet e vlerës së tyre dhe të vlerës financiare



shtesë zbatohen parashikimet në nenin 8 të këtij vendimi.

Neni 8

Përlllogaritja e vlerës së pasurive që shpronësohen

1. Përlllogaritja e vlerës, si për pasuritë pronë private që shpronësohen, edhe për pasuritë në pronësi të shtetit, bëhet duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësim, për interes publik, sipas legjislacionit në fuqi. Në përlllogaritjen e vlerës së pasurive përfshihen investimet e kryera me leje në këto pasuri, si mbi- dhe nëntokë. Investimet e kryera pa leje, si mbi- dhe nëntokë nuk përfshihen në përlllogaritjen e vlerës së pasurisë.

2. Në rast se pasuria pronë private që shpronësohet rezulton me vlerë më të lartë se pasuria pronë shtetërore që do të shërbejë për shpërblimin në natyrë, subjekti, pasuria e të cilit do të shpronësohet, përfiton diferencën në vlerë financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik.

3. Në rast se pasuria pronë private që shpronësohet rezulton me vlerë më të ulët se pasuria pronë shtetërore që do të shërbejë për shpërblimin në natyrë, subjekti, prona e të cilit do të shpronësohet, do të paguajë diferencën në vlerë financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronat e paluajtshme shtetërore.

4. Vlera financiare shtesë që duhet të paguajë pronari i pasurisë, pronë private, sipas pikës 3 të këtij

neni, parashikohet si detyrim në marrëveshjen që lidhet ndërmjet pronarit të pronës private dhe ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore. Nënshkrimi i marrëveshjes nënkupton dhënien e pëlqimit dhe të dakordësisë nga ana e pronarit të pasurisë së paluajtshme pronë private.

5. Të ardhurat që përfitohen, sipas pikës 3 të këtij neni, depozitohen në llogarinë e shpronësimeve, në Bankën e Shqipërisë.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e vendimit

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 416 lekë